



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 62 regjistër (JR)
Datë 12.12.2019

Nr. 5 i vendimit
Datë 15.03.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 15.03.2022, në orën 09:00, ditën e martë, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Ornella Balla, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 62/2019, datë 12.12.2019, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 197, datë 27.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, neni 42, neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoji subjektin e rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, dhe avokaten e saj R. Z, të cilat përfundimisht, në mënyrë alternative, kërkuan prishjen e vendimit nr. 197, datë 27.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duke vazhduar procesin e rivlerësimit edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale ose ndryshimin e vendimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, ndërsa në momentin e dhënies së vendimit objekt shqyrtimi ishte caktuar gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportin e hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), sipas të cilit: *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; dhe subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave; si dhe raportet e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).*

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Trupi gjykues i Komisionit, pas shqyrtimit të çështjes, arriti në konkluzionet përfundimtare se subjekti i rivlerësimit: *i). ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1991 - 2016, me një balancë (-) 8.800.000 lekë; ii). ka deklarim të pamjaftueshëm për të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit; iii). ka deklarim të pasaktë për shkollimin privat të vajzës, duke fshehur pagesën e kryer; iv). nuk justifikon ligjshmërinë e burimit të krijimit për huan, në kuptim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016; v). ka deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016; vi). nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke vendosur përfundimisht: 1). Shkarkimin nga detyra të*

subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë. [...].

III. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit nr. 197, datë 27.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në datën 13.11.2019, ushtroi ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore¹.

4.1. Para shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike, subjekti i rivlerësimit ka dërguar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) parashtrime me shkrim dhe akte në datat 07.10.2021, 18.10.2021, 28.10.2021 dhe 02.12.2021².

5. Nga shqyrtimi tërësor i ankimit dhe i parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, ndaj vendimit të Komisionit, janë evidentuar në mënyrë të përmbledhur shkaqet e ankimit si më poshtë.

A. Shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe anën procedurale të procesit të rivlerësimit

5.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka cenuar procesin e rregullt ligjor dhe ka paragjykuar çështjen ndaj saj duke zhvilluar procesin e rivlerësimit bazuar vetëm në një kriter dhe, për këtë qëllim, kërkon riçeljen e hetimit dhe shqyrtimin në themel të fakteve e provave nga Kolegji për të tria kriteret. Për kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit pretendon se pasaktësitë e palidhura me indicie për korrupsion apo veprimtari të tjera të papajtueshme apo të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrës, nuk mund të jenë shkak shkarkimi.

5.2. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka përmbushuar standardin e gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme dhe ka paragjykuar vendimin, pasi në rolin e hetuesit, ka bërë hetimin administrativ, mbledhjen e provave dhe ngritjen e dyshimeve ndaj subjektit të rivlerësimit, me vlerësime të natyrës përgjithësuese vetëm për kriterin e pasurisë dhe, nga ana tjetër, duke refuzuar të merrte provat e kërkuara nga subjekti i rivlerësimit, i ka mohuar të drejtën për të provuar të kundërtën. Subjekti i rivlerësimit thekson se anëtarët e trupës gjyqësore nuk mund të ushtrojnë si funksione hetimore, ashtu edhe gjyqësore.

5.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, pas paraqitjes së provave shkresore nga ana e saj dhe kërkesës për plotësimin e hetimit administrativ me pyetjen e dëshmitarëve, si dhe në drejtim të kriterit të figurës dhe aftësive profesionale, Komisioni do të duhet të kishte disponuar me vendim

¹ Vendimi i arsyetuar i Komisionit i është njoftuar subjektit të rivlerësimit në datën 29.10.2021, Institucionit të Komisionerëve Publikë në datën 25.10.2021 dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në datën 24.10.2021, dhe ndaj tij është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit në datën 13.11.2019, i cili u pranua nga Komisioni me vendimin nr. {***}, datë 18.11.2019.

² Regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 07.10.2021, nr. {***} prot., datë 18.10.2021, nr. {***} prot., datë 28.10.2021 dhe nr. {***} prot., datë 01.12.2021.

të ndërmjetëm, sipas nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016, duke bërë të ditur edhe arsyen lidhur me refuzimin e marrjes së këtyre provave. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk duhet të rezervonte të drejtën e arsyetimit në vendimin përfundimtar, pasi vetëm në këtë mënyrë ajo pretendon se do të kishte pasur mundësi që të provonte faktet dhe, me mjetet e tjera ligjore, të diktonte në mënyrë të ligjshme vendimmarrjen përfundimtare të Komisionit.

5.4. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka shkelur parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit duke e trajtuar në mënyrë të diferencuar në raport me subjekte të tjera rivlerësi, për të cilat procesi është kryer i plotë për të tria kriteret. Për subjektet e tjera të rivlerësimit, i njëjti relator ka trajtuar të njëjtat problematika.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

5.5. Lidhur me apartamentin me sip. 135,9 m² në rr. {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, ka pretenduar se:

5.5.1. nuk gjendej në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie;

5.5.2. ka gabime në llogaritjen e pagave për të ardhurat për periudhën 1992 - qershor 2004, për totalin e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit;

5.5.3. metodologjia e shpenzimeve familjare për periudhën 1992 - 2000 nuk është në përputhje me parimet ekonomike dhe shpenzimet e jetesës për të përcaktuar një minimum jetik;

5.5.4. kishte aftësi paguese për shlyerjen në datën 17.01.2005, të kredisë në {***}, e cila ishte disbursuar në datën 17.10.2003, në vlerën prej 2.126.600 lekësh, me qëllim për t'u përdorur për blerjen e apartamentit me sip. 135,9 m² në rr. {***}, Tiranë, me argumentin se kishte likuiditete të lira në fund të vitit 2004.

5.6. Lidhur me garazhin me sip. prej 14 m² në Farkë, Tiranë, subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, ka pretenduar se: kishte mundësi kursimi të shumës prej 900.000 lekësh të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë 2013 si vlerë likuiditetesh, gjendje cash.

5.7. Lidhur me analizën financiare për vitet 2006, 2007, 2009, 2011, 2014 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se:

5.7.1. për sa i përket apartamentit me sip. 111,5 m² në Shkodër, për të financuar blerjen e kësaj pasurie, kishte marrë huan prej 5.000.000 lekësh nga z. V.V , sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.01.2011;

5.7.2. lidhur me automjetin tip {***}, në fund të vitit 2007, kishte likuiditete për të kryer paradhënien për financimin e blerjes së automjetit në shumën prej 8.000 eurosh, si rezultat i mbartjeve të diferencave pozitive të analizave ndër vite;

5.7.3. sa i përket apartamentit me sip. ndërtimi $95 \text{ m}^2 + 14,3 \text{ m}^2$ në Farkë, kishte mundësi financiare për të kryer pagesat;

5.7.4. sa i përket analizës financiare për vitet 2006, 2007, 2009, 2011, 2014 dhe 2015, Komisioni në mënyrë të padrejtë, të paqartë dhe të pajustificueshme, nuk i ka konsideruar të ardhurat e honorarëve nga ish-KLD, dhe nga ana tjetër i ka konsideruar shpenzimet për udhëtimet e kryera në Spanjë, Francë dhe Portugali në vitet 2005 – 2009. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se ishte në vështirësi dhe pamundësi për të kryer deklarime të sakta të të ardhurave të bashkëshortit, sepse afati i deklarimit në ILDKPKI mbaron në datën 31 mars të vitit kalendarik, ndërkohë mbyllja e bilancit për efekt të tatimeve, nga ekonomisti i personit fizik, noter, vjen më vonë në kohë, dhe se provat e dorëzuara e mbulojnë plotësisht kërkesën e Komisionit për sqarim lidhur me shpenzimet e shkollimit dhe të jetesës jashtë vendit për të dy fëmijët.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

6. Trupi gjykues i Kolegjit, gjatë shqyrtimit të çështjes mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, me qëllim korrigjimin e shkeljeve procedurale të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me konstatimin e drejtë të situatës faktike, vendosi të kalojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit, si dhe thirrjen në cilësinë e dëshmitarit të z. V. V. Dëshmitari dha dëshminë e tij në seancën gjyqësore publike të datës 18.02.2022, lidhur me justifikimin me burime të ligjshme të huas së dhënë subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në datën 29.01.2011. Gjithashtu, bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të marrë në cilësinë e provës aktet shkresore të paraqitura nga dëshmitari gjatë pyetjes së tij.
7. Vëzhguesja ndërkombëtare depozitoi në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit një gjetje, bazuar në nenin 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, e cila iu njoftua subjektit të rivlerësimit. Në seancën gjyqësore publike të datës 04.03.2022, subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, nëpërmjet avokates R. Z, mbajti qëndrimin e saj lidhur me gjetjen e vëzhgueses ndërkombëtare, e cila u administrua nga trupi gjykues.
8. Në vijim të kërkesës së paraqitur nga avokatja R. Z në seancën gjyqësore publike të datës 04.03.2022, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, si dhe në nenin 49, pika 6, germat “a”, “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, vendosi të mos pranojë në cilësinë e provës

aktet e depozituara në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit në ankimin e datës 18.11.2019 dhe, pas depozitimit të ankimit, në datat 07.10.2021, 18.10.2021, 28.10.2021 e 02.12.2021.

8.1. Sa u përket akteve të paraqitura në Kolegj në datën 07.10.2021, përkatësisht: a) shkresës *kthim përgjigje* nr. {***} prot., datë 30.09.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër³ (në vijim “GjRrGjSh”), për të vërtetuar se nuk kishte konflikt gjyqësor ndërmjet z. A. H dhe znj. Sh. H, z. A. H., z. A. H dhe z. A. H; b) deklaratës *me shkresë të thjeshtë* datë 27.09.2021 të z. M. B dhe znj. V. B⁴, për të vërtetuar se nga viti 1999 në apartamentin në Shkodër, derisa u larguan në Tiranë, kishte jetuar vetëm familja e subjektit të rivlerësimit; dhe c) fotografisë gjatë një gostie të organizuar, me qëllim për të provuar marrëdhënien shoqërore me familjen B., Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit i ka paraqitur këto akte pas ankimit, kur ligji lejon vetëm paraqitjen e parashtrimeve⁵. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar se pa fajin e tij nuk ishin paraqitur në Komision, ndërsa në përmbajtje pretendon të provojë fakte në favor të tij, të cilat, edhe po të konsiderohen të vërteta, nuk ndikojnë në marrjen e vendimit dhe janë të panevojshme për procesin e rivlerësimit.

8.1.1. Për këtë arsye, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, si dhe në nenin 49, pika 6, shkronjat, “a” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, Kolegji vendosi të mos i pranojë në cilësinë e provës aktet e mësipërme.

8.2. Sa u përket akteve të paraqitura në Kolegj në datën 18.10.2021, përkatësisht: a) kërkesës, datë 08.10.2021, të subjektit të rivlerësimit⁶ drejtuar EKB-së; dhe b) shkresës *dërgim dokumentacioni* nr. {***} prot., datë 11.10.2021, të EKB-së⁷, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit i ka paraqitur këto

³ Së bashku me printime të pjesshme të sistemit informatik të brendshëm të menaxhimit të çështjeve në GjRrGjSh, dhe vendimin nr. {***}, datë 13.05.2010 të GjRrGjSh-së, me kërkesues z. A. H dhe objekt lëshim dëshmie trashëgimie ligjore për të ndjerin, z. Sh. H.

⁴ Së bashku me: a) vërtetimin nr. {***} prot., datë 09.11.2000, të Bashkisë Shkodër, sipas të cilit z. M. B kishte përfituar të drejtën e trajtimit si familje e pastrehë; b) kontratë shpërblimi me këste nr. {***} rep., nr. {***} kol. datë 15.12.2012, ndërmjet EKB-së dhe blerësve z. M. B, znj. V. B dhe z. P. B; c) vërtetim pronësie, datë 12.05.1999, të Zyrës së Hipotekës Shkodër, me pronar RKB-në; ç) autorizimin, datë 22.10.1996, të Bashkisë Shkodër, Komunale, sipas të cilit Këshilli i Strehimit kishte vendosur që z. M. B të sistemohej në pallatin që po ndërtohej nga viti 1995; d) certifikatë familjare, datë 18.04.2011, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Shkodër, L. 4, kryefamiljar z. M. B, bashkëshorte znj. V. B, i biri z. P. B; dh) vërtetimin, datë 02.11.2012, të shoqërisë “{***}”, sipas të cilit z. P. B ishte i punësuar nga data 01.10.2002; e) vërtetimin, datë 23.10.2012, të INSTAT-it, sipas të cilit znj. V. B ishte punonjëse e INSTAT-it; ë) vërtetimin nr. {***}, datë 10.12.2012, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, sipas të cilit personi juridik V. K, në emrin e z. P. B, kishte deklaruar e paguar kontributet për muajin tetor 2012; f) mandatarkëtimin nr. {***}, datë 16.06.2003, të EKB-së, nga z. M. B; g) mandatpagesën, datë 29.04.2011, të {***}, nga znj. V. B në favor të EKB-së, për këstin e parë të banesës; dhe gj) aktin e llogaritjes së çmimit të apartamentit.

⁵ Vendimet nr. 22/2020 (JR) dhe nr. 33/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁶ Së bashku me certifikatën familjare, datë 08.10.2021, të Zyrës së Gjendjes Civile pranë Njësisë Administrative Farkë, Bashkia Tiranë, me kryefamiljar z. A. H, bashkëshorte znj. Dhurata Haveri, e bija znj. E. H dhe i biri z. E. H.

⁷ Së bashku me: a) vërtetimin nr. {***} regj., datë 06.02.2004, të Ministrisë së Drejtësisë, dhe vendimin nr. {***}, datë 09.02.1996, të Komisionit Qendror të Dhënies së Statusit të Veteranit të Luftës; b) certifikatën për vërtetim pronësie, datë 12.02.2004, kartelën e pasurisë së paluajtshme, datë 12.02.2004, dhe hartën treguese të regjistrimit, datë 12.02.2004, të Zyrës

akte pas ankimit, kur ligji lejon vetëm paraqitjen e parashtrimeve⁸ dhe nuk ka provuar se, pa fajin e tij, nuk ishin paraqitur në Komision, ndërsa në përmbajtje, janë të parëndësishme për vendimmarrjen.

8.2.1. Për këtë arsye, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, si dhe në nenin 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, Kolegji vendosi të mos i pranojë në cilësinë e provës aktet e mësipërme.

8.3. Edhe për sa u përket këtyre akteve të paraqitura në Kolegji në datën 28.10.2021, përkatësisht: a) deklaratës, datë 24.10.2021⁹, të z. V. V; dhe b) deklaratës, datë 24.10.2021¹⁰, të z. V. V dhe z. A. T, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit këto akte i ka paraqitur pas ankimit, kur ligji lejon vetëm paraqitjen e parashtrimeve¹¹ dhe nuk ka provuar se, pa fajin e tij, nuk ishin paraqitur në Komision, ndërsa sipas jurisprudencës së Kolegjit¹², ato kanë vlerë të kufizuar provuese.

8.3.1. Për këtë arsye, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, si dhe në nenin 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, Kolegji vendosi të mos i pranojë në cilësinë e provës aktet e mësipërme.

8.4. Sa i përket shkresës nr. {***} prot., datë 24.11.2021, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim “AShK”), të paraqitur në Kolegji në datën 02.12.2021, nëpërmjet së cilës vërtetohet se Njësia e Menaxhimit të Projektit për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme (në vijim “NjMPPPP”) ka qenë strukturë në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, e krijuar për menaxhimin e projektit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, vëren se subjekti i rivlerësimit këtë shkresë e ka paraqitur pas ankimit, kur ligji lejon vetëm paraqitjen e parashtrimeve¹³ dhe nuk ka provuar se, pa fajin e tij, nuk ishte paraqitur në Komision. Nuk provohet nga kjo shkresë pamundësia objektive e subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, për të paraqitur dokumentacionin justifikues për të ardhurat e përfituara nga z. V. V në kuadër të këtij projekti. Ky akt ishte i parëndësishëm për vendimmarrjen, në drejtim të provueshmërisë dhe justifikimit të krijimit të të ardhurave të ligjshme nga z. V. V, deklarin e tyre, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore, sipas përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

8.4.1. Për këtë arsye, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, si dhe në nenin 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, Kolegji vendosi të mos pranojë në cilësinë e provës aktin e mësipërm.

*së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, për pasurinë nr. {***}, zk {***}, vol. {***}, f. {***}, me sip. 75,26 m², në lagjen {***}, Shkodër, me pronar EKB-në; c) procesverbalin, datë 18.02.2004, të EKB-së dhe z. A. H, lidhur me kthimin z. A. H të shumës së parave prej 135.315 lekësh; ç) kontratën e shitjes së apartamentit të banimit me pagesë të menjëhershme nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 20.02.2004, ndërmjet EKB-së dhe z. A. H, znj. Sh. H, z. A. H, z. A. H dhe z. A. H.*

⁸ Vendimet nr. 22/2020 (JR) dhe nr. 33/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁹ Së bashku me vërtetimin e nënshkrimit nr. {***} rep., datë 24.10.2021, dhe letërnjoftimin e deklaruesit.

¹⁰ Së bashku me vërtetimin e nënshkrimit nr. {***} rep., datë 24.10.2021, dhe letërnjoftimet e deklaruesve.

¹¹ Vendimet nr. 22/2020 (JR) dhe nr. 33/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹² Vendimet nr. 6/2018 (JR), nr. 11/2019 (JR), nr. 34/2019 (JR), nr. 23/2020 (JR) dhe nr. 11/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹³ Vendimet nr. 22/2020 (JR) dhe nr. 33/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

9. Në lidhje me shkakun e ankimit se procesi i kryer nga Komisioni është bazuar vetëm në një kriter, atë të pasurisë, duke kërkuar riçeljen e hetimit dhe shqyrtimin në themel të fakteve e provave nga Kolegji edhe për kriteret e figurës dhe të aftësive profesionale, trupi gjykues, në përputhje me jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit¹⁴, bazuar në nenin 4, pika 2, fjalia e fundit e ligjit nr. 84/2016¹⁵, vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur në ligj për arsye se vendimi mund të merret edhe bazuar në një prej kritereve të rivlerësimit, sikurse në rastin konkret për kriterin e pasurisë dhe, për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit nuk është cenuar në të drejtat e tij. Në zbatim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për konfirmimin në detyrë të subjektit kërkohet plotësimi së bashku i kushteve për të tria kriteret e rivlerësimit – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Nëse subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, edhe nëse vlerësimi për dy kriteret e tjera do të ishte pozitiv, institucionet e rivlerësimit japin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra¹⁶.

9.1. Për sa i përket shkakut të ankimit se pasaktësitë e palidhura me indicie për korrupsion apo veprimtari të tjera të papajtueshme apo të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrës, nuk mund të jenë shkak shkarkimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur në faktet dhe rrethanat e çështjes konkrete, sepse shkaqet e shkarkimit, Komisioni i ka bazuar kryesisht në mungesën e burimeve financiare për të justifikuar shpenzimet për periudhën 1991 - 2016, në shumën prej (-) 8.800.000 lekësh, në deklarin e pamjaftueshëm të të ardhurave nga aktiviteti privat i bashkëshortit, në mosjustifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të huas, dhe në tërësi se subjekti i rivlerësimit kishte kryer deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë dhe nuk kishte arritur të shpjegonte bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive.

9.2. Pretendimi se pasaktësitë e palidhura me indicie për korrupsion apo veprimtari të tjera të papajtueshme apo të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrës, nuk mund të jenë shkak shkarkimi, nuk është i mbështetur në ligj, për arsye se në këtë proces, subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim. Organet e rivlerësimit kanë si qëllim që të identifikojnë ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur¹⁷. Në asnjë rast përcaktimet kushtetuese dhe ligjore nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklarin me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit në kuptimin penal, sikurse korrupsioni, apo me veprimtari të tjera të papajtueshme apo të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrës.

¹⁴ Vendimet nr. 6/2018 (JR), nr. 1/2019 (JR), nr. 12/2019 (JR), nr. 15/2019 (JR), nr. 29/2019 (JR), nr. 3/2022 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹⁵ Neni 4, pika 2, fjalia e fundit e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “[...] Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”.

¹⁶ Vendimi nr. 22/2021 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹⁷ Vendimet nr. 34/2019 (JR) dhe nr. 13/2020 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

10. Në lidhje me shkakun e ankimit se anëtarët e trupit gjykues të Komisionit nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht funksione hetimore dhe gjyqësore, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit¹⁸, *trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur në ligj, në kushtet kur veprimtaria e Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese.*

10.1. Gjithashtu në çështjen gjyqësore Xh. kundër Shqipërisë, për pretendime të njëjta të kërkuases me sa më sipër¹⁹, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GjEDNj”) ka vlerësuar se nuk ka shkelje të nenit 6, pika 1 e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”) në drejtim të parimit të gjykatës së paanshme²⁰.

11. Në lidhje me shkakun e ankimit se, pas paraqitjes së provave shkresore nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe kërkesës për plotësimin e hetimit administrativ me pyetjen e dëshmitarëve, si dhe në drejtim të kriterit të figurës dhe aftësive profesionale, Komisioni do të duhet të kishte disponuar me vendim të ndërmjetëm, sipas nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016, duke bërë të ditur edhe arsyen, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit²¹, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur në ligj, për arsye se, pas kalimit të barrës së provës, Komisioni, vlerësimin për çdo provë, akt/dokument dhe shpjegim, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, e kryen në tërësi, nëpërmjet vendimit përfundimtar dhe, rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, nuk është cenuar në të drejtat e saj.

11.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, pas përfundimit të hetimeve paraprake në datën 27.06.2019, Komisioni vendosi të njoftonte subjektin e rivlerësimit mbi përfundimin e hetimit kryesisht të çështjes të nisur në datën 15.05.2018, që paraprakisht kishte përfunduar vetëm për kriterin e pasurisë. Në vijim, me vendimin e ndërmjetëm, datë 17.07.2019, Komisioni e gjeti të pambështetur kërkesën e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet parashtrimeve mbi rezultatet e hetimit, datë 15.07.2019²², për marrjen e dëshmisë së z. V. V, vendim i cili nuk rezulton t’i jetë njoftuar subjektit të rivlerësimit dhe as të jetë asyetuar mbi këtë vendim të ndërmjetëm në vendimin përfundimtar.

11.2. Trupi gjykues i Kolegjit, gjatë shqyrtimit të çështjes mbi bazë dokumentesh, bazuar në nenin 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), me qëllim korrigjimin e shkeljeve procedurale të Komisionit dhe lidhur me konstatimin e drejtë të situatës

¹⁸ Vendimi nr. 34/2021 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹⁹ Paragrafi 230 i vendimit të GjEDNj-së, Xh. kundër Shqipërisë.

²⁰ Paragrafët 307, 308 dhe 317 të vendimit të GjEDNj-së, Xh. kundër Shqipërisë.

²¹ Vendimet nr. 1/2019 (JR), nr. 2/2019 (JR), nr. 5/2019 (JR), nr. 1/2020 (JR), nr. 2/2020 (JR), nr. 3/2020 (JR), nr. 6/2020 (JR), nr. 12/2020 (JR), nr. 17/2020 (JR), nr. 20/2020 (JR), nr. 29/2020 (JR), nr. 4/2021 (JR), nr. 19/2021 (JR), nr. 22/2021 (JR), nr. 26/2021 (JR), nr. 28/2021 (JR) dhe nr. 31/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

²² F. 13, paragrafi i katërt i parashtrimeve mbi rezultatet e hetimit.

faktike, vendosi të kalojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit, si dhe të thërrasë në cilësinë e dëshmitarit, z. V. V.

12. Në lidhje me shkakun e ankimit se Komisioni ka shkelur parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit duke e trajtuar në mënyrë të diferencuar në raport me subjekte të tjera rivlerësi, për të cilat procesi është kryer i plotë për të tria kriteret nga i njëjti relator dhe me të njëjtat problematika, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur në ligj. Në mënyrë të konsoliduar në jurisprudencën e tij, Kolegji²³ ka vlerësuar se çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, duke u bazuar në specifikat e gjendjes faktike për çdo subjekt rivlerësi, të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, nuk është cenuar në të drejtat e saj.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

13. Lidhur me apartamentin me sip. 135,9 m² në rr. “{***}”, Tiranë, me vlerë prej 69.309 eurosh, të blerë në vitin 2003, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se janë të mbështetura në prova dhe në ligj pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, lidhur me konkluzionet e arritura në Komision²⁴, se nuk justifikonte mundësinë e kursimeve²⁵, sipas arsyetimit që do të shtjellohet në vijim.

13.1. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, për apartamentin në rr. “{***}”, Tiranë, sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 19.05.2003, ka deklaruar si burim të ardhurat nga paga, nga shitja e pasurisë së paluajtshme, sipas kontratës së shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.06.2004 dhe kredi bankare nga {***}, Dega Shkodër (në vijim “{***}”).

13.2. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, se Komisioni ka kryer në mënyrë të pasaktë llogaritjen e të ardhurave nga pagat e saj, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, sipas llogaritjes së Komisionit, të ardhurat e dokumentuara për subjektin e rivlerësimit, për periudhën 1992 - qershor 2004, rezultojnë të jenë në shumën prej 4.829.181 lekësh. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar në prova për arsye se, duke llogaritur të ardhurat nga punësimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën 1992 – 1999, në shumën prej

²³ Vendimet nr. 20/2021 (JR) dhe nr. 25/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

²⁴ Sipas analizës financiare të Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk justifikonte mundësinë e kursimeve në shumën prej (-) 3.080.013 lekësh.

²⁵ Për sa u përket gabimeve në llogaritjen e pagave, për sa i përket metodologjisë së shpenzimeve familjare për periudhën 1992 - 2000 që, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk është në përputhje me parimet ekonomike dhe shpenzimeve të jetesës për të përcaktuar një minimum jetik, dhe duke pretenduar se kishte pasur aftësi paguese për shlyerjen e kredisë në {***} në datën 17.01.2005, me argumentin se ka pasur likuiditete të lira në fund të vitit 2004 në shumën prej 1.209.459 lekësh.

1.733.934 lekësh, të ardhurat nga punësimi në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër (në vijim “ULGSh”) për periudhat 1992 - 1996 dhe 2001 - 2002 në shumën prej 42.865 lekësh, të ardhurat nga punësimi në Gjykatën e Apelit Shkodër (në vijim “GjASh”) për periudhën 2000 - 2004 në shumën prej 2.662.289 lekësh dhe të ardhurat nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë (në vijim “GjAKRT”) deri në muajin qershor 2004, në shumën prej 390.096 lekësh, totali i të ardhurave për këtë periudhë rezulton në shumën me diferencë jodomethënëse prej 4.829.184 lekësh.

13.2.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren llogaritje të gabuara në analizën financiare të Komisionit, në pjesën e të ardhurave për vitet 1992, 1995, 1996, 2001, 2002²⁶, në vlerën prej (-) 6.734 lekësh. Për vitin 1999, totali i të ardhurave, në fakt rezulton me vlerë më të lartë prej 82.496 lekësh²⁷, ndërsa të ardhurat nga GjASh-ja janë llogaritur me një diferencë të shtuar prej 390.092 lekësh, përkatësisht në shumën prej 3.052.381 lekësh, nga shuma prej 2.662.289 lekësh.

13.2.2. Duke krahasuar llogaritjen e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1992 – 2003, sipas Komisionit, në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sipas aktit të ekspertimit kontabël, datë 13.07.2019, të paraqitur në Komision prej tij, rezulton se Komisioni i ka llogaritur ato në vlerën prej 4.280.880 lekësh, vlerë kjo më e lartë se ajo e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet aktit të ekspertimit, në vlerën prej 4.069.310 lekësh, me një ndryshim prej 211.570 lekësh²⁸. Gjithashtu, në vlerë më të lartë është edhe llogaritja që Komisioni u ka bërë të ardhurave të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1991 – 2003, në vlerën prej 1.410.258 lekësh, në raport me aktin e ekspertimit kontabël të paraqitur prej tij në datën 13.07.2019, në vlerën prej 1.202.134 lekësh, me një ndryshim prej 208.124 lekësh.

13.2.3. Trupit gjykues të Kolegjit, ndryshe nga llogaritja e pagës së subjektit të rivlerësimit në vitin 1999, në vlerën prej 485.160 lekësh, të ardhurat nga paga në këtë vit i rezultojnë në vlerën prej 441.600 lekësh²⁹, me një diferencë prej (-) 43.560 lekësh, e cila vlerësohet nga trupi gjykues që

²⁶ Sipas mbledhjes së të dhënave në tabelë për vitet përkatëse ka ndryshime me totalin e paraqitur në tabelën në vendim, pra në vitin 1992, totali sipas të ardhurave në tabelë, është 5.261 lekë, ndërsa në vendim është 9.051 lekë; në vitin 1995, totali sipas të ardhurave në tabelë është 236.645 lekë, ndërsa në vendim është 238.118 lekë; në vitin 1996, totali sipas të ardhurave në tabelë është 232.334 lekë, ndërsa në vendim është 232.645 lekë; në vitin 2001, totali sipas të ardhurave në tabelë është 572.357 lekë, ndërsa në vendim është 572.928 lekë; në vitin 2002, totali sipas të ardhurave në tabelë është 638.195 lekë, ndërsa në vendim është 638.784 lekë.

²⁷ Në vitin 1999, totali sipas të ardhurave në tabelë është 485.160 lekë, ndërsa në vendim është 402.664 lekë.

²⁸ Komisioni, në krahasim me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, i ka konsideruar më shumë të ardhura ndër vite, përveç viteve 1996 - 1997. Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 18.10.2016, nuk ka pasur të ardhura si pedagoge nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër në vitin 1997. Po ashtu, edhe sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 20.09.2019, të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, konfirmohen të ardhura deri për vitin 1996, pra jo për vitin 1997. Të ardhurat e vitit 1996 nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, në vlerën prej 8.909 lekësh, janë më të larta se ato të konsideruara nga Komisioni, në vlerën prej 5.807 lekësh, por më të vogla se të ardhurat e konsideruara në akt ekspertimin e subjektit të rivlerësimit, në vlerën prej 23.280 lekësh.

²⁹ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 2.9.2019, të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, referuar ligjit nr. 8332, datë 23.04.1998, gjyqtarët në gjykatat e rretheve e kishin pagën 34.500 lekë dhe, më pas, me hyrjen në fuqi të vendimit nr. 235, datë 22.05.1999, të Këshillit të Ministrave, paga e gjyqtarit në gjykatat e rretheve u bë 37.950 lekë. (për 4 muaj, janar – prill, paga e subjektit të rivlerësimit konsiderohet në vlerën prej 34.500 lekësh x 4 muaj = 138.000

nuk duhet të pasqyrohet në analizën e këtij viti. Në Kolegj, janë konsideruar të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, si pedagoge në ULGSh në vitin 1993, në vlerën prej 8.670 lekësh, ndryshe nga llogaritja e Komisionit në vlerën prej 6.118 lekësh. Gjithashtu në Kolegj, në vitin 1995 të ardhurat janë llogaritur në vlerën prej 17.979 lekësh, ndryshe nga llogaritja e Komisionit në vlerën prej 4.645 lekësh, ndërsa në vitin 1996 janë llogaritur në vlerën prej 8.909 lekësh, ndryshe nga llogaritja e Komisionit në vlerën prej 5.807 lekësh. Në total, Kolegjit i rezultoi në vlerën e shtuar prej 18.988 lekësh, në raport me llogaritjet e Komisionit, përveç vitit 1994, që edhe Kolegjit i rezultuan të njëjtat vlera me llogaritjet e Komisionit.

13.2.4. Duke kryer saktësimet në llogaritjet e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1992 - qershor 2004, bazuar mbi aktet në fashikull, si dhe duke konsideruar në analizën financiare për këtë periudhë të ardhurat e pallogaritura nga Komisioni, trupit gjykues të Kolegjit i rezultoi se të ardhurat nga punësimi i subjektit të rivlerësimit dhe i bashkëshortit për periudhën tetor 1991 - qershor 2004, konsiderohen të kenë qenë në vlerën prej 6.258.430 lekësh.

13.3. Për sa i përket *metodologjisë së shpenzimeve familjare për periudhën 1992 - 2000*, trupi gjykues vëren se, sipas metodologjisë së përdorur nga Komisioni, shpenzimet e jetesës për periudhën 1991 - 1996, janë konsideruar në vlerën prej 70% të të ardhurave familjare, për periudhën 1997 - 1999 janë konsideruar në vlerën prej 5.000 lekësh/muaj/për person dhe nga viti 2000 dhe në vijim janë konsideruar sipas metodologjisë së përdorur nga ILDKPKI-ja, bazuar në të dhënat e INSTAT-it³⁰.

13.3.1. Trupi gjykues, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit³¹, shpenzimet e jetesës për periudhën 1991 - 1999 i konsideron duke marrë parasysh pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, për t'u përlllogaritur në nivelin 30% - 40% të të ardhurave, mbi bazën e faktorëve të pretenduar, si: niveli i jetesës në rrethin e Shkodrës, periudhat transitorë të viteve 1997 - 1998, ku minimumi jetik lidhet vetëm me nevojat ekzistenciale të ushqimit dhe jo të privilegjeve të tjera. Në funksion të një analize financiare shteruese, trupit gjykues të Kolegjit, duke i llogaritur në nivelin 30% të të ardhurave, shpenzimet e jetesës për periudhën 1991 - 1999 i rezultuan në vlerën prej 773.443 lekësh dhe, duke i konsideruar sipas ILDKPKI-së, bazuar në standardin e INSTAT-it për periudhën 2000-2003, në vlerën prej 1.614.912 lekësh dhe deri në datën 14.06.2004, në vlerën prej 172.084 lekësh. Pra, në total shpenzimet e jetesës të konsideruara nga Kolegji për periudhën 1991 deri në 14.06.2004, rezultojnë në vlerën 2.560.439 lekë, ndryshe nga Komisioni i cili i ka konsideruar në vlerën prej 3.192.222 lekësh.

13.4. Në përmbyllje, duke kryer saktësimet në llogaritjet e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, për periudhën 1992 - qershor 2004, duke konsideruar në analizën financiare për këtë periudhë të ardhurat e pallogaritura nga Komisioni dhe duke kryer një analizë financiare

lekë e më pas, për maj – dhjetor, paga e subjektit konsiderohet në vlerën prej 37.950 lekësh x 8 muaj = 303.600, dhe për të gjithë vitin 1999, në vlerën prej 441.600 lekësh).

³⁰ Vendimi nr. 197, datë 27.09.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, f. 13, pika "a".

³¹ Vendimi nr. 15/2021 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

shtruese për shpenzimet e jetesës për periudhën 1991- qershor 2004, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte burime të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera në vlerën prej 44.421 lekësh³².

13.4.1. Sa i përket pagesës së vlerës së apartamentit me sip. 75,26 m², në lagjen “{***}” në Shkodër, të blerë nga EKB-ja nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.02.2004, dhe të shitur më pas nëpërmjet kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.06.2004, trupi gjykues vëren se, sipas nenit 4 të kësaj kontrate³³, pagesa është bërë para nënshkrimit të kontratës, pa përcaktuar momentin e pagesës. Kjo pagesë mund të jetë bërë edhe para ose në datën 14.06.2004, kur është bërë pagesa e kështit të fundit për apartamentin me sip. 135,9 m² në rr. “{***}”, Tiranë.

13.4.2. Për sa i përket përfitimit të të gjithë shumës prej dy milionë lekësh, trupi gjykues konstatoi se apartamenti me sip. 75,26 m² në Shkodër është përdorur në mënyrë të pandërprerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Edhe pse nga certifikata rezultonte në bashkëpronësi, nga aktet e administruara në fashikull, provohet që të gjitha veprimet, sa i përket plotësimit të dokumentacionit për përfitimin/pagesën e këtij apartamenti, përkundrejt EKB-së, janë bërë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. H.

13.4.2.1. Trupi gjykues vëren se, edhe pse ishin në të njëjtën certifikatë familjare, familjarët e bashkëshortit nuk kanë jetuar asnjëherë në këtë apartament, pasi nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka jetuar vazhdimisht në një shtëpi tjetër prej vitit 1994. Vëllezërit e bashkëshortit, duke qenë se ishin emigrantë jashtë vendit, përveç se nuk kanë jetuar në këtë shtëpi, nuk kishin shfaqur asnjë interes në drejtim të pronësisë. Në këto kushte, nga aktet dhe shpjegimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit, rezulton që familja e subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, e përbërë nga vetë ajo, bashkëshorti dhe fëmijët, ka qenë përdoruesja e vetme e pasurisë apartament me sip. 75,26 m², në lagjen “{***}” në Shkodër. Së fundmi, sa i përket përfitimit të të gjithë shumës prej dy milionë lekësh, trupi gjykues, në përputhje me nenin 764, paragrafi i parë të Kodit Civil³⁴, i cili e parashikon aktin formal për vlefshmërinë e veprimit juridik vetëm për dhurimet e pasurive të paluajtshme dhe nuk e kërkon një të tillë për dhurimet e pasurive të luajtshme, siç janë likuiditetet, në kushtet e një marrëdhënieje të posaçme ndërmjet familjarësh dhe në rrethana si ato të sipërcituara, për trupin gjykues është i besueshëm mosformalizimi i dhurimit për shkak të marrëdhënieve të posaçme prindërore e vëllazërore, si dhe referuar traditës, dhe rrjedhimisht përfitimi i të gjithë vlerës prej 2.000.000 lekësh, të shitjes së apartamentit me sip. 75,26 m², në lagjen “{***}” në Shkodër.

³² Përkatesisht, të ardhura në vlerën prej 10.937.763 lekësh, zbritur shpenzimet në vlerën prej 2.789.677 lekësh dhe pasuritë në vlerën prej 8.103.665 lekësh.

³³ Sipas të cilit: “Në marrëveshje në mes palëve kontraktuese, çmimi i shitjes së kësaj pasurie të paluajtshme është caktuar në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë. Shumë e cila është likuiduar totalisht nga blerësi jashtë kësaj zyre noteriale dhe pala shitëse pranoi se e mori të tërë shumën në dorëzim”.

³⁴ I cili parashikon se: “Dhurimi i sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt publik dhe të regjistrohet, përndryshe është i pavlefshëm”.

13.4.3. Për sa i përket përfitimit të vlerës së shitjes së mobilieve të apartamentit me sip. 75,26 m², në lagjen “{***}” në Shkodër, për vlerën prej 600.000 lekësh, trupi gjykues, në përputhje me nenin 148, paragrafi i dytë i Kodit Civil³⁵, vlerëson se ato mund të jenë edhe objekt i një disponimi të veçantë, duke krijuar të ardhura më vete. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto të ardhura në deklarimin e interesave pasurorë periodikë/vjetorë, si dhe e ka konfirmuar përfitimin e shumës prej 600.000 lekësh edhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna në Komision dhe, për këto arsye, trupi gjykues i konsideron të ligjshme këto të ardhura.

13.4.4. Në analizën e kryer në Kolegj, në të ardhurat e subjektit të rivlerësimit janë konsideruar: **a)** të ardhurat e periudhës tetor 1991 - qershor 2004, të cilat u saktësuan si më sipër cituar në paragrafët 13.3.1 dhe 13.4 dhe që rezultuan më shumë se Komisioni, në vlerën prej 18.988 lekësh³⁶; **b)** të ardhurat nga shitja e apartamentit të bashkëshortit në Shkodër, për vlerën totale prej 2.000.000 lekësh³⁷; **b)** të ardhurat nga shitja e mobilieve të apartamentit për vlerën prej 600.000 lekësh³⁸; dhe **c)** të ardhurat e bashkëshortit si regjisor pranë Teatrit Migjeni Shkodër (në vijim “TMSH”) në vlerën prej 1.410.258 lekësh; **ç)** të ardhurat nga kredia në {***} në vlerën prej 2.079.333 lekësh, në total në vlerën prej 10.937.763 lekësh.

13.4.5. Shpenzimet e jetesës, në Kolegj, rezultuan në vlerën prej 2.560.439 lekësh³⁹, ndërsa shpenzimet e kredisë në {***}, sikurse dhe llogaritja e Komisionit, edhe Kolegjit i rezultoi në vlerën prej 229.238 lekësh, në total në vlerën prej 2.789.677 lekësh.

13.4.6. Vlera e pasurive, në Kolegj, rezultoi 7.795.120 lekë⁴⁰, e ndryshme nga Komisioni i cili e kishte llogaritur në vlerën prej 7.668.780 lekësh, duke përdorur kurse këmbimi të ndryshme, ndërsa sikurse Komisionit, ashtu edhe Kolegjit, për automjetin e blerë në vitin 2001, i rezultoi vlera prej 300.000 lekësh, dhe për ndryshimet e likuiditeteve i rezultoi vlera prej 8.545 lekësh. Në total, Kolegjit, vlera e pasurive i rezultoi në vlerën prej 8.103.665 lekësh, vlerë kjo e cila nuk u konsiderua në analizë, me qëllim përlllogaritjen e mundësisë për të justifikuar me burime të ligjshme krijimin e pasurive deri në qershor 2004, në zbatim të parimit “*no reformato in peius*”.

³⁵ Neni 148, paragrafi i dytë i Kodit Civil, parashikon se: “Aksesorët mund të jenë edhe objekt i një disponimi të veçantë”.

³⁶ Për 4.848.172 lekë, llogaritur në Kolegj me mbledhjen e saktë të shifrave të Komisionit prej 4.829.184 lekësh ose për 18.991 lekë, krahasuar me shumën 4.829.181 lekë, konsideruar në analizë nga Komisioni.

³⁷ Sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.06.2004, ndryshe nga Komisioni, i cili ka konsideruar në analizë vetëm 1/5 e çmimit të shitjes 2.000.000 lekë sipas kontratës, pra shumën 400.000 lekë në analizën e vitit 2004. Sipas analizës financiare, në rezultatet hetimore të para dhe në rezultatet hetimore shtesë, por jo në analizën e kryer (tetor 1991- 14.06.2004) deri në momentin e kryerjes së pagesës së fundit nga subjekti dhe personat e lidhur për blerjen e apartamentit në rr. “{***}”, Tiranë të shumës 12.000 euro ose 1.497.600 lekë, mandat depozitimi në {***}, i datës 14.06.2004.

³⁸ Sipas deklarimit të interesave në ILDKPKI, në vitin 2004.

³⁹ Ose 631.783 lekë më pak se përlllogaritjet e Komisionit prej 3.192.222 lekësh, sipas analizës në vendim, faqe 13.

⁴⁰ Në Kolegj janë konvertuar me kurset e ditëve të pagesave sipas mandatarkëtimit në {***}, datë 19.05.2003, për 18.000 euro (ose ekuivalenti 2.534.040 lekë), mandatarkëtimit në {***}, datë 30.10.2003, për 20.000 euro (ose ekuivalenti 2.705.400 lekë), mandatarkëtimit në {***}, datë 29.12.2003, për 8.000 euro (ose ekuivalenti 1.058.080 lekë) dhe mandat depozitimit në {***}, datë 14.06.2004, për 12.000 euro ose 1.497.600 lekë.

13.4.7. Në analizën e kryer në Kolegj, bazuar në vlerën prej 7.668.780 lekësh të pasurisë së përlllogaritur në Komision, duke konsideruar të ardhurat si më sipër përshkruar në paragrafin 13.4.4, trupit gjykues i rezultoi se deri më 14.06.2004, subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, kishte burime të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament me sip. 135,9 m² në rr. “{***}”, Tiranë. Pra, subjekti rezultoi me mundësi financiare të ligjshme, me një vlerë pozitive në shumën prej 170.761 lekësh.

14. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kishte pasur aftësi paguese për shlyerjen e kredisë në {***} në datën 17.01.2005, në shumën prej 2.170.000 lekësh, duke argumentuar se kishte pasur likuiditete të lira në fund të vitit 2004, në shumën 1.209.459 lekë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur në prova dhe në ligj dhe, si pasojë, subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shlyerjen, sipas arsyetimit që do të shtjellohet në vijim.

14.1. Në mbështetje të pretendimit se kishte pasuri, likuiditete të lira, në fund të vitit 2004, në shumën prej 1.209.459 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktin e ekspertimit kontabël, datë 13.07.2019, sipas të cilit mundësisë së kursimit për vitin 2004, në vlerën prej 851.184 lekësh⁴¹, i shtohet edhe mbartja e vitit 2003, në vlerën prej 358.275 lekësh⁴².

14.2. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se likuiditetet e pretenduara në aktin e ekspertimit kontabël, datë 13.07.2019, nuk janë deklaruar në deklaratën e personit që mbartte detyrim për deklarim pasurie, viti 2003, dhe as në deklarinimin e vitit 2004 dhe, si pasojë, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit⁴³, ato nuk mund të konsiderohen në analizën financiare të viteve përkatëse. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si burim për shlyerjen e kredisë edhe likuiditetet e pretenduara.

14.3. Si burim për mbylljen e kredisë në {***} në datën 13.01.2005, në shumën prej 2.105.000 lekësh, subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë të vitit 2005, ka deklaruar huan prej 1.000.000 lekësh, të marrë nga znj. M. B⁴⁴ në vitin 2005. Pavarësisht se palët kishin deklaruar se huaja do të kthehej në datën 12.01.2008, sikurse edhe subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar⁴⁵, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi e kthyer kjo hua.

14.4. Trupit gjykues të Kolegjit i rezulton se për periudhën 15.06.2004 - 31.12.2004, totali i të ardhurave të subjektit të rivlerësimit⁴⁶ ishte në vlerën prej 710.913 lekësh, duke zbritur shpenzimet

⁴¹ Si diferencë për një total “Të ardhura” prej 3.259.217 lekësh dhe “Shpenzime” prej 2.408.032 lekësh.

⁴² Sipas analizave në aktin e ekspertimit, datë 13.07.19, sjellë nga subjekti, i referohet diferencës pozitive/likuiditete të lira të analizës kryer nga 1991-2003, prej 358.275 lekësh (të ardhura 7.441.444 lekë - shpenzime 7.083.169 lekë).

⁴³ Vendimet nr. 8/2019 (JR), nr. 11/2019 (JR), nr. 19/2019 (JR), nr. 29/2019 (JR), nr. 1/2020 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁴⁴ Sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.01.2005.

⁴⁵ Në përgjigjet e pyetësorit, datë 24.05.2019, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “2. Lidhur me pikën e dytë, deklaroj se pjesa e mbetur në lidhje me huan e marrë shtetases M. B., do të deklarohet kur të likuidohet”.

⁴⁶ Nga totali i të ardhurave të 1.259.217 lekëve, konsideruar në analizën deri më 14.06.2004, vlera prej 548.304 lekësh, pra për periudhën janë 710.913 lekë.

prej 497.923 lekësh⁴⁷, dhe duke shtuar edhe rezultatin pozitiv të analizës financiare deri në datën 14.06.2004, në vlerën prej 170.761 lekësh⁴⁸. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, në fund të vitit 2004, do të kishin pasur mundësi për të kursyer deri në 383.751 lekë⁴⁹.

14.5. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, edhe në kuadër të një analize shteruese⁵⁰, vlera që do të rezultonte do të ishte e pamjaftueshme për të justifikuar shlyerjen e plotë të shumës prej 2.105.000 lekësh në datën 13.01.2005, në {***}, duke zbritur nga kjo shumë huan prej 1.000.000 lekësh nga znj. M. B, subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, rezulton me një diferencë të pajustificuar me burime të ligjshme në vlerën prej (-) 586.905 lekësh⁵¹.

15. Lidhur me garazhin me sip. prej 14 m² në Farkë, Tiranë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, se kishte pasur likuiditete të mjaftueshme për të shlyer detyrimin, është i mbështetur dhe subjekti i rivlerësimit ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, sipas arsytimit që do të shtjellohet në vijim.

15.1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, për garazhin me sip. prej 14 m² në Farkë, Tiranë, me vlerë prej 5.000 eurosh, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.05.2015, të shlyer nëpërmjet mandatarkëtimeve nr. {***}, datë 01.04.2014, në shumën prej 2.000 eurosh, nr. {***}, datë 15.04.2014, në shumën prej 2.000 eurosh dhe nr. {***}, datë 30.04.2014, në shumën prej 1.000 eurosh, ka deklaruar si burim të ardhurat nga puna e të dy bashkëshortëve.

15.2. Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit potencialisht kishte pasur pjesërisht mundësi për të kryer pagesat si rrjedhojë e deklaramit të gjendjes *cash* prej 900.000 lekësh në vitin 2013, por për Komisionin, subjekti i rivlerësimit rezultonte se kishte mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera në vitin 2013, në vlerën prej (-) 271.767 lekësh dhe në vitin 2014, në vlerën prej (-) 1.670.039 lekësh dhe, si pasojë, nuk kishte burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

⁴⁷ Si total i shpenzimeve të jetesës për 4 persona për vitin 2004 sipas ILDKPKI-së, për 6 muaj prej 187.728 lekësh, shpenzime për kreditë sipas lëvizjeve të llogarisë bankare në {***} për pagesat prej 274.674 lekësh dhe shpenzime udhëtimi prej 35.521 lekësh.

⁴⁸ Nëse do të korrigjohet vlera e analizës financiare për apartamentin në rr. "{***}", Tiranë, sipas Komisionit në vlerën prej 7.668.780 lekësh, nga vlera e konsideruar në Kolegj prej 7.795.120 lekësh, kjo vlerë do të ishte 170.761 lekë.

⁴⁹ Nëse do të korrigjohej vlera e analizës financiare për apartamentin në rr. "{***}", Tiranë, kjo vlerë do të ishte 383.751 lekë.

⁵⁰ Vendimet nr. 24/2021 (JR), nr. 25/2021 (JR), nr. 3/2022 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁵¹ Po të konsiderohet se deri në mbylljen e kredisë më 13.01.2005 [pasi nuk ka lëvizje të llogarisë në janar 2005 për të vërtetuar datat e kalimeve të pagës], subjekti do të kishte marrë gjithë pagën e janarit prej 134.344 lekësh [e gjithë paga e subjektit për 15-ditëshin e dytë të dhjetorit prej 30.627 lekësh dhe e janarit prej 103.717 lekësh, sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 23.01.2017, nga Gjykata e Krimeve të Rënda Tiranë] e do të ishte përdorur për shlyerjen e kredisë, pa konsideruar këtu shpenzime të tjera të kryera nga familja deri më 13.01.2005, atëherë do të rezultonte me një diferencë prej (-) 586.905 lekësh për të mbuluar shumën e shlyer të kredisë me burime të ligjshme).

15.3. Në kuadër të një analize financiare shteruese, Kolegji mori në shqyrtim mundësinë e kursimit të shumës prej 900.000 lekësh, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë 2013 si vlerë likuiditetesh, gjendje *cash*.

15.4. Në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzime jetese në shumën prej 900.000 lekësh, ndërkohë që rezultojnë edhe shpenzimet për shkollimin e vajzës në Universitetin New York, Tiranë (në vijim “UNYT”), në shumën prej 473.209 lekësh⁵² dhe, në këto kushte, Komisioni ka konsideruar në analizën financiare të vitit 2013 shpenzime, në total, në shumën prej 1.373.209 lekësh⁵³, përveç shpenzimeve të tjera.

15.5. Duke konsideruar pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me shpenzimet e jetesës të deklaruar në vlerën prej 900.000 lekësh, në raport me shpenzimet e shkollimit prej 473.209 lekësh, diferenca e mbetur prej 426.791 lekësh konsiderohet si shpenzim jetese për familjen. Duke i krahasuar këto shpenzime me shpenzimet e jetesës sipas standardeve të ILDKPKI-së për vitin 2013 për familje me katër persona, në vlerën prej 564.096 lekësh, diferenca e mbetur si shpenzime jetese do të rezultonte më e ulët se ky standard, konkretisht me 137.305 lekë.

15.6. Në vijim, duke konsideruar pretendimin e mësipërm të subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare të vitit 2013, totali i shpenzimeve të jetesës së familjes dhe shpenzimeve të shkollimit të vajzës prej 1.019.305 lekësh dhe, duke shtuar edhe shpenzimet e llogaritura nga Komisioni për udhëtimet, në vlerën prej 367.559 lekësh, në total shpenzimet e vitit 2013 rezultojnë të kenë qenë në vlerën prej 1.404.864 lekësh.

15.7. Në këto kushte, të ardhurat e vitit 2013, në shumën prej 2.354.044 lekësh, rezultojnë të mjaftueshme për të justifikuar kryerjen e shpenzimeve prej 1.404.864 lekësh. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se në fund të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit mund të kursente⁵⁴ gjendjen *cash* prej 900.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë të vitit 2013 dhe, rrjedhimisht edhe pagesat prej 5.000 eurosh, ose ekuivalentin prej 700.200 lekësh për blerjen e garazhit me sip. prej 14 m² në Farkë, Tiranë.

16. Lidhur me analizën financiare për vitet 2006, 2007, 2009, 2011, 2014 dhe 2015, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë të mbështetura në prova dhe në ligj dhe, si pasojë, ai gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë apartament me sip. 111,5 m² në Shkodër, automjet tip “{***}” dhe apartament me sip. ndërtimi 95 m² + 14,3 m² në Farkë, si dhe shpenzimet e kryera në këto vite, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, sipas arsyesimit që do të shtjellohet në vijim.

⁵² Sipas shkresës nr. {***}prot., datë 07.08.2019, të UNYT-së, konfirmohen pagesat për gusht 2012 - qershor 2014, për vitin 2013 në shumën prej 473.209 lekësh.

⁵³ 900.000 lekë, shpenzimet e jetesës dhe 473.209 lekë, shpenzimet e shkollimit.

⁵⁴ Rezultojnë të ardhura 2.354.044 lekë, zbritur shpenzimet prej 1.404.864 lekësh, zbritur dhe pakësimi i likuiditeteve 160.007 lekë, rezultonte me + 1.109.187 lekë mundësi për të kursyer në *cash*, por subjekti i rivlerësimit ka deklaruar 900.000 lekë në deklaratën vjetore periodike.

17. Për sa i përket apartamentit me sip. 111,5 m² në Shkodër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri, sipas arsyetimit që do të shtjellohet në vijim.

17.1. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, për apartamentin me sip. 111,5 m² në Shkodër, me vlerë prej 4.761.050 lekësh, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.02.2011, ka deklaruar si burim të ardhurat nga huaja prej 5.000.000 lekësh nga z. V. V, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.01.2011.

17.2. Nga deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë 2011, 2012, 2013, rezulton se ka deklaruar kthimin huadhënësit të shumës prej 4.100.000 lekësh, prej totalit të së cilës ka mbetur e pashlyer shuma prej 900.000 lekësh.

17.3. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se para datës 29.01.2011, kur subjekti i rivlerësimit pretendon se ka marrë huan prej 5.000.000 lekësh nga z. V. V, në funksion të çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 111,5 m² në Shkodër, nga bashkëshorti i saj janë kryer dy pagesa, përkatësisht në datën 15.10.2009, në shumën prej 5.000 eurosh dhe në datën 28.11.2009, në shumën prej 15.000 eurosh⁵⁵.

17.4. Për të vlerësuar justifikimin me burime të ligjshme të shumës prej 5.000.000 lekësh në datën 29.01.2011, nga z. V. V, Komisioni ka konsideruar të ardhurat e përfituara prej tij nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Shkodër (në vijim “AShK”), sipas shkresës datë 09.09.2019, për periudhën 2003 - 2009, sipas së cilës z. V. V kishte përfituar të ardhura të ligjshme në vlerën prej 2.048.238 lekësh, dhe duke pranuar se ai mund të kursente vlerën prej 1.328.280 lekësh. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se deri në datën 31.12.1999, z. V. V kishte pasur një depozitë në ish- {***}, në shumën prej 1.905.406 lekësh dhe në datën 31.12.2000, në shumën prej 3.511.505 lekësh, por Komisionit nuk i rezultoi që z. V. V të kishte qenë i siguruar si punonjës i shoqërisë “{***}”⁵⁶ për t’i konsideruar si të ligjshme këto shuma.

Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, në përgjigje të pyetësorit të datës 03.05.2019, për të vërtetuar të ardhurat e z. V. V, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentet: a) vërtetimin nr. {***} prot., datë 16.01.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër (në vijim “DRTSh”), nga e cila rezultonte se z. V. V ishte drejtues teknik i shoqërisë “{***}”⁵⁷; b) licencën nr. {***}, e lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Komisioni i Dhënies së Licencave Profesionale (në vijim “KDhLP”), për drejtuesin teknik V. V; c) vërtetimin nr. {***} prot., datë 03.05.2012, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër (në vijim “DRSShSh”), sipas të cilit, për z. V. V, ishin paguar kontributet e sigurimeve shoqërore

⁵⁵ Sipas mandatarkëtimeve nr. {***}, datë 15.10.2006, dhe nr. {***}, datë 28.11.2009 të shoqërisë “{***}”, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit datë 03.05.2019.

⁵⁶ F. 17, paragrafi i pestë i vendimit nr. 197, datë 27.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

⁵⁷ Të regjistruar me vendimin nr. {***}, datë 07.05.1996, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, e cila nuk rezultonte e regjistruar me NIPT apo të dhëna të tjera.

e shëndetësore për periudhën 01.01.1997 - 31.12.1999⁵⁸; ç) vendimin nr. {***} regj., datë 07.05.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e shoqërisë “{***}”; d) dëftesën e arkëtimit nga shoqëria topografike “{***}” pranë Drejtorisë Postare Shkodër (në vijim “DPSH”), për efekt të pagesave të tatim fitimit⁵⁹; dh) raportet për kryerjen e porosisë së punimeve për përgatitjen e hartave⁶⁰; e) mandatarëkëtimin nga V. V, gusht 1996⁶¹, shuma 2.000 lekë; dhe ë) tërheqjen nga llogaria në {***}, me urdhërues z. V. V, në shumën 917.700 lekë⁶².

17.4.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nga dokumentet e mësipërme të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se z. V. V ka pasur cilësinë e drejtuesit teknik në shoqërinë “{***}”, dhe në këtë cilësi nuk rezultojnë të dokumentuara të ardhura të ligjshme të përfituara prej tij. Subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, por dhe z. V. V me dëshminë e tij, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, nuk provuan me dokumentacion llojin e marrëdhënies juridike të vendosur ndërmjet tij dhe shoqërisë “{***}”, si dhe të ardhurat të cilat do të përfitoheshin bazuar në këtë marrëdhënie juridike. Sa i përket periudhës 1997 - 1999, kur rezultojnë të paguara kontributet për sigurimin e detyrueshëm shoqëror, nuk rezultojnë të provuara të ardhurat e përfituara prej z. V. V, pavarësisht të ardhurave që kishte përfituar shoqëria nga veprimtaria e saj gjatë kësaj periudhe. Lidhur me shumën 917.700 lekë, të tërhequr në datën 10.08.2011 nga {***}, nuk rezulton cili është burimi i krijimit të saj dhe, përveç kësaj, tërheqja e kësaj shume është kryer disa muaj pas dhënies së huas, duke u përjashtuar edhe për shkak të këtij fakti mundësia e përdorimit si burim krijimi i huas prej 5 milionë lekësh. Në kushtet kur nga vendimi nr. {***}, datë 07.05.1996, i Gjykatës së Rrethit Tiranë, rezulton se shoqëria “{***}” ishte regjistruar në vitin 1996, me drejtues teknik z. V. V, trupi gjykues vlerëson se z. V. V nuk mund të siguronte të ardhura që i përkasin periudhës para datës 07.05.1996, nga një shoqëri që nuk ishte regjistruar sipas ligjit. Të ardhurat e z. V. V për periudhën para regjistrimit të shoqërisë “{***}” në vitin 1996, nuk u provuan dhe për më tepër që kjo shoqëri, nga e cila pretendon të ardhura, ka nisur ekzistencën konkretisht në datën 07.05.1996, që nënkupton si rrjedhojë një periudhë kohore pas asaj gjatë së cilës është pretenduar përfitimi që ka ndihmuar në huadhënien e pretenduar në vitin

⁵⁸ Në mënyrë konkrete vetëm për muajt janar - dhjetor vitit 1999, në shumën prej 32.340 lekësh.

⁵⁹ Nr. {***} tatim fitimi, paradhënie për 3-mujorin e tretë të vitit 1996, shuma 10.000 lekë; nr. {***} tatim fitimi për 3-mujorin e katërt të vitit 1996 shuma, 10.000 lekë; nr. {***} tatim fitimi për 3-mujorin e parë të vitit 1997, shuma 17.500 lekë; nr. {***} tatim fitimi, sipas bilancit të vitit 1997, shuma 100 lekë; nr. {***} tatim fitimi për 3-mujorin e dytë të vitit 1997, shuma 17.500 lekë; nr. {***} diferencë tatim fitimi për 3-mujorin e parë të vitit 1998, shuma 2.800 lekë; nr. {***} tatim fitimi për 3-mujorin e tretë të vitit 1998, shuma 20.000 lekë; nr. {***} tatim fitimi për 3-mujorin e katërt të vitit 1998, shuma 20.000 lekë; nr. {***} tatim fitimi për 3-mujorin e katërt të vitit 1999, shuma 26.500 lekë; nr. {***} tatim solidariteti për 3-mujorin e katërt të vitit 1999, shuma 5.000 lekë.

⁶⁰ Zona kadastrale {***} - {***}, rrethi Malësi e Madhe, gjatë muajve tetor - nëntor - dhjetor 2001, janar - shkurt - mars 2002, shuma 1.479.195 lekë, i porosituri shoqëria topografike “{***}” dhe faturë nr. {***}, datë 23.04.2002; zona kadastrale {***} - {***}, rrethi Malësi e Madhe, gjatë muajve tetor - nëntor - dhjetor 2001, janar - shkurt - mars 2002, shuma 1.679.225 lekë, i porosituri shoqëria topografike “{***}” dhe faturë nr. {***}, datë 17.04.2002; zona kadastrale {***} - {***}, rrethi Malësi e Madhe gjatë muajve tetor - nëntor - dhjetor 2001, janar - shkurt - mars 2002, shuma 167.923 lekë, i porosituri shoqëria topografike “{***}” dhe faturë nr. {***}, datë 23.04.2002.

⁶¹ Nr. {***}, datë 13.08.1996, materiale ndërtimi.

⁶² Nr. i llogarisë {***}, me përshkrim V. V në datën 10.08.2011.

2011. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë se z. V. V kishte krijuar të ardhura të ligjshme në periudhën 1999 - 2002, për arsye se dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si fatura dhe situacione⁶³, referojnë në aktivitetin ekonomik të shoqërisë “{***}”, por jo të ardhura të përfituara nga z. V. V.

17.4.2. Lidhur me pretendimin e z. V. V, të deklaruar gjatë dëshmisë së dhënë në Kolegj, se ai kishte qenë një nga tre ortakët e kësaj shoqërie, trupi gjykues nuk e gjeti të bazuar atë në referencë të vendimit nr. {***}, datë 07.05.1996, të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe akteve të regjistrimit të shoqërisë tregtare “{***}”.

17.5. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, në përgjigje të pyetësorit, datë 23.08.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin nr. {***} prot., datë 15.08.2019, të {***}⁶⁴, sipas të cilit rezulton se z. V. V ka pasur një depozitë të çelur në ish- {***} në datën 08.12.1997 dhe të mbyllur në datën 23.10.2002⁶⁵, dhe se shuma e depozitës, në datën 31.12.1999, ishte 1.905.406 lekë dhe në datën 31.12.2000, ishte 3.511.505 lekë.

17.5.1. Në vijim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nga dokumenti i mësipërm, rezulton se z. V. V ishte mbajtës i një depozite në ish- {***} në periudhën 1997 - 2002, për të cilën është i panjohur burimi dhe të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer në momentin e krijimit të saj, ndërsa nuk rezulton i provuar në asnjë akt historiku i kësaj depozite, vlera që ajo kishte në mbyllje të saj, si dhe destinimi i shumës së tërhequr nga momenti i mbylljes deri në momentin e dhënies së huas. Të dhënat që rezultojnë nga vërtetimi i referuar në paragrafin 17.6 më sipër, janë se në datën 31.12.1999, z. V. V kishte tepërisht shumën 1.905.406 lekë dhe në datën 31.12.2000, kishte shumën 3.511.505 lekë, shumë kjo që në tërësinë e saj, nuk rezultoi e provuar të ketë qenë e krijuar me të ardhura që mund të konsiderohen të ligjshme nga z. V. V, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, apo që ai e zotëronte këtë shumë *cash* në vitin 2011, në momentin e dhënies së huas subjektit të rivlerësimit.

17.6. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në seancën gjyqësore publike të datës 18.02.2022, z. V. V⁶⁶ paraqiti këto dokumente: a) vendimin nr. {***}, datë 14.07.2009, për çështjen me nr. akti 2046 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; b) shkresën nr. {***} prot., datë 03.03.2010, të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër (në vijim “ZVRPP”), së bashku

⁶³ Sikurse: a) fatura nr. {***}, datë 03.04.2002, shitësi “{***}”, emri i blerësit dhe objekti i shitjes shuma 1.479.495 lekë; b) fatura nr. {***}, datë 17.04.2002, shitësi “{***} ShPK”, blerësi M.M.P.SR.M.P.; c) situacioni, datë 17.04.2002, për kryerjen e porosisë së punimeve për përgatitjen e HTR Zona Kadastrale {***}- {***}, rrethi Malësia e Madhe, gjatë muajve tetor-nëntor-dhjetor 2001, janar-shkurt-mars 2002, shuma 167923 lekë; ç) situacioni, datë 17.04.2002, për kryerjen e porosisë së punimeve për përgatitjen e HTR Zona Kadastrale {***}- {***}, rrethi Malësia e Madhe, gjatë muajve tetor-nëntor-dhjetor 2001, janar-shkurt-mars 2002, shuma 1679225 lekë; d) situacioni, datë 22.04.2002, për kryerjen e porosisë së punimeve për përgatitjen e HTR Zona Kadastrale {***}- {***}, rrethi Malësia e Madhe, gjatë muajve tetor-nëntor-dhjetor 2001, janar-shkurt-mars 2002, shuma 1479195 lekë.

⁶⁴ Dokument i paraqitur edhe në seancën gjyqësore publike të datës 18.02.2012.

⁶⁵ Nuk ka të dhëna për shumën në fillim dhe në fund të periudhës.

⁶⁶ Duke përjashtuar shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 15.08.2019, të {***} ShA, Dega Shkodër, e cila ishte paraqitur edhe nga subjekti i rivlerësimit në Komision.

me lajmërimin për ekzekutim vullnetar nr. {***} prot., datë 11.02.2010, të Zyrës së Përmbartimit Shkodër (në vijim “ZPSH”), Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit, Ministria e Drejtësisë dhe vendimin për kalim në ekzekutim të detyrueshëm nr. {***} prot., datë 25.02.2010, të ZPSH-së; dhe c) nxjerrjen e llogarisë, datë 15.01.2019, të {***} ShA, Dega Shkodër, për llogarinë e z. V. V nr. {***}, për periudhën 20.09.2010 - 15.01.2019.

17.6.1. Nga dokumentet e mësipërme, rezulton se z. V. V ka përfituar të ardhura të ligjshme, si pasojë e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor në datën 20.10.2010, në shumën prej 39.500 lekësh⁶⁷; në datën 25.11.2010, në shumën prej 4.500 lekësh⁶⁸; në datën 23.12.2010, në shumën prej 4.500 lekësh⁶⁹; në datën 02.02.2011, në shumën prej 870.480 lekësh⁷⁰.

17.6.2. Në total, në llogari të z. V. V rezulton të jetë kredituar shuma prej 918.980 lekësh, ndërkohë që para dhënies së huas në datën 29.01.2011, deri në fund të vitit 2010, ishte kredituar vetëm shuma prej 48.500 lekësh, ndërsa pjesa tjetër prej 870.480 lekësh ishte kredituar në datën 02.02.2011, pas dhënies së huas. Në këto kushte, shuma prej 870.480 lekësh, e kredituar në llogari pas dhënies së huas, nuk konsiderohet si burim krijimi i huas prej 5.000.000 lekësh, dhënë subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, në datën 29.01.2011.

17.6.2.1. Në vijim, rezulton se gjendja e llogarisë prej 48.300.76 lekësh në datën 04.01.2011, është shtuar me pagesën e datës 02.02.2011, me shumën prej 870.480 lekësh dhe, pas pakësimit në vlerën prej 18.100 lekësh⁷¹, shuma prej 900.000 lekësh është investuar në depozitë me afat deri në datën 09.08.2011, me vlerë maturimi prej 917.673.53 lekësh, dhe përfundimisht është tërhequr në datën 10.08.2011 nga z. V. V, vlera prej 917.700 lekësh. Kjo vlerë e tërhequr, 917.700 lekë, korrespondon me aktin tërheqje llogarie, akt në fashikujt e Komisionit⁷², por rezulton se ky akt i referohet një veprimi pas dhënies së huas.

17.7. Për sa më sipër, duke mos konsideruar huan prej 5.000.000 lekësh nga z. V. V, i cili nuk ka arritur të justifikojë më burime të ligjshme këtë hua, Kolegji lidhur me apartamentin me sip. 111,5 m², Shkodër, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri në shumën prej (-) 2.364.582 lekësh, sipas analizës financiare për periudhën 2006 – 2011, për të krijuar pasurinë e mësipërme dhe për të përballuar shpenzimet⁷³.

⁶⁷ Me përshkrim: “Xhirim shume të derdhur nga ZRPP Shkodër MA {***} DT 16/09/2010 lekë 5.0000, {***} dt. 21/09/2010 lek 30.000, {***} dt 07/10/10 lek 4500 / V. M. V (OCT 19 1955)”.

⁶⁸ Me përshkrim: “Xhirim shume të derdhur nga ZRPP Shkodër MA {***} dt 01/11/2010 / V. M. V (OCT 19 1955)”.

⁶⁹ Me përshkrim: “Xhirim shume të derdhur nga ZRPP Shkodër / V. M. V (OCT 19 1955)”.

⁷⁰ Me përshkrim: “Xhirim shume të derdhur nga ZRPP Shkodër {***} dhe ZQRRPP Tiranë për {***} / V. M. V (OCT 19 1955)”.

⁷¹ Në datat 04.02.2011 dhe 08.02.2011, mbajtur komision 100 lekë dhe tërhequr në ATM vlera 18.000 lekë

⁷² Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetjes nr. {***} në pyetësorin, datë 03.05.2019, e ka paraqitur origjinalet më tej në Komision.

⁷³ Si total i diferencave negative të analizës totale të vitit 2006 prej (-) 138.182 lekësh, kur është paguar vlera prej 5.000 eurosh për apartamentin sipas mandatit të vitit 2009 prej (-) 1.741.499 lekësh, kur është paguar vlera prej 15.000 eurosh për apartamentin sipas mandatit dhe të vitit 2011 prej (-) 484.901 lekësh, kur është lidhur kontrata e shitblerjes së pasurisë për diferencën e paguar të çmimit total prej 4.761.050 lekësh.

Bazuar në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji thekson se Komisioni për të vlerësuar mundësinë financiare për të justifikuar me burime të ligjshme këtë pasuri, duhet të kishte kryer analizën financiare për periudhën deri në ditën e kryerjes së pagesës shitësit nga subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri. Nga kontrolli i kryer në vendimin e Komisionit, në analizën financiare të këtyre viteve, Kolegji konfirmon minimalisht të njëjtin rezultat të analizës së viteve, ashtu si dhe Komisioni: për vitin 2006, në vlerën prej (-) 138.182 lekësh; për vitin 2009, në vlerën prej (-) 1.741.499 lekësh; për vitin 2011, në vlerën prej (-) 484.901 lekësh dhe në total, në vlerën prej (-) 2.364.582 lekësh.

18. Për sa i përket automjetit tip “{***}”, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit që në fund të vitit 2007 ka pasur likuiditete për të kryer paradhënien për financimin e automjetit prej 8.000 eurosh, janë të pambështetura dhe, si pasojë, gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri, sipas arsytimit që do të shtjellohet në vijim.

18.1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, për automjetin tip “{***}”, me vlerë prej 19.000 eurosh⁷⁴, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.04.2008, ka deklaruar si burim të ardhurat nga paga dhe nga shitja e automjetit sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.09.2008.

18.2. Nga kontrolli, rezulton se automjeti tip “{***}”, me vlerë 19.000 euro, është financuar me 8.000 euro paradhënie nga subjekti i rivlerësimit dhe pjesa tjetër nëpërmjet kontratës së qirasë financiare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.04.2008, nga {***}⁷⁵. Përveç paradhënies prej 8.000 eurosh, subjekti i rivlerësimit duhej të paguante edhe komisionin e administrimit në masën 1,5 % të shumës së financuar, në shumën prej 165 eurosh.

18.3. Në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë 2007, subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, ka deklaruar gjendje *cash* prej 1.500.000 lekësh, ndërsa Komisionit në këtë vit subjekti i rivlerësimit i ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera në vlerën prej (-) 906.686 lekësh, duke vlerësuar se deri në datën e kryerjes së parapagimit, njësia ekonomike familjare ka pasur të ardhura rreth 557.000 lekë, pa zbritur këtu shpenzimet apo pagesa të tjera dhe pa përfshirë të ardhurat nga shitja e automjetit tjetër në datën e mëvonshme, 27.09.2008, në çmimin prej 100.000 lekësh.

18.4. Sipas aktit të ekspertimit kontabël, datë 13.07.2019, të ekspertit kontabël E. S⁷⁶, në analizën financiare të vitit 2007, mundësia reflektohet me diferencën e pajustificuar prej (-) 741.432 lekësh⁷⁷, por nëpërmjet mbartjes së vitit 2006 në vlerën prej 1.781.908 lekësh, që vjen si rezultat i

⁷⁴ Vlera e financimit 10.999,99 euro dhe paradhënia 8.000,01 euro.

⁷⁵ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 16.11.2018, të {***} dhe lëvizjeve të llogarisë.

⁷⁶ Kontabël i miratuar E. S, licencë nr. {***}.

⁷⁷ Si diferencë për një total “Të ardhura” prej 1.447.337 lekësh dhe “Shpenzime” prej 2.188.769 lekësh.

mbartjeve të diferencave pozitive të analizave ndër vite⁷⁸, subjekti i rivlerësimit pretendon se kishte likuiditete të lira në vlerën prej 1.040.476 lekësh.

18.5. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar likuiditetet *cash*, të pretenduara në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë 2004 - 2006⁷⁹ dhe, si pasojë, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit⁸⁰, ato nuk mund të konsiderohen në analizën financiare të viteve përkatëse.

18.6. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit se në fund të vitit 2007, kishte likuiditete të lira në vlerën prej 1.040.476 lekësh, bien ndesh edhe me deklarimin në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë 2007, ku vetë subjekti ka deklaruar si *të holla cash, vlerën 1.500.000 lekë*.

18.7. Në kuadër të një analize financiare shteruese, duke u mbështetur në analizën e subjektit të rivlerësimit për vitin 2007, ku të ardhurat janë konsideruar në vlerën prej 1.447.337 lekësh, duke zbritur shpenzimet prej 688.769 lekësh⁸¹, diferenca do të ishte në vlerën prej 758.568 lekësh, e ndryshme gjithashtu nga sa është deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë 2007, në vlerën prej 1.500.000 lekësh.

18.8. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur në fillim të vitit 2008 do të kishin mundësinë për të kursyer jo më shumë se 758.568 lekë. Duke i shtuar të ardhurat deri në datën 29.04.2008⁸² të subjektit të rivlerësimit prej 420.139 lekësh⁸³, në total mundësia e kursimeve do të rezultonte në vlerën prej 1.178.707 lekësh. Kjo vlerë nuk do të ishte e mjaftueshme për të

⁷⁸ Sipas analizave në Aktin e Ekspertimit, datë 13.07.19, sjellë nga subjekti si total i diferencave pozitive/likuiditete të lira të analizës kryer nga 1991-2003 prej 358.275 lekësh (të ardhura 7.441.444 lekë – shpenzime 7.083.169 lekë), e cila është mbartur në analizën e kryer të vitit 2004, duke iu shtuar rezultatit të vitit prej 851.185 lekësh (të ardhura 3.259.217 lekë – shpenzime 2.408.032 lekë), pra në fund të vitit 2004, subjekti pretendon likuiditete të lira prej 1.209.459 lekësh; e cila është mbartur në analizën e kryer të vitit 2005, duke iu shtuar rezultatit të vitit prej 473.475 lekësh (të ardhura 3.136.335 lekë – shpenzime 2.662.860 lekë), pra në fund të vitit 2005, subjekti pretendon likuiditete të lira prej 1.682.934 lekësh; e cila është mbartur në analizën e kryer të vitit 2006, duke iu shtuar rezultatit të vitit prej 98.974 lekësh (të ardhura 1.393.890 lekë – shpenzime 1.294.916 lekë), pra në fund të vitit 2006, subjekti pretendon likuiditete të lira prej 1.781.908 lekësh; e cila është mbartur në analizën e kryer të vitit 2007, mbledhur me rezultatit e vitit prej – 741.432 lekësh (të ardhura 1.447.337 lekë – shpenzime 2.188.769 lekë), pra në fund të vitit 2007, subjekti pretendon likuiditete të lira prej 1.040.476 lekësh.

⁷⁹ Në deklarimin e vitit 2004, nuk ka deklaruar pasuri apo shtim pasurie për “likuiditetet e lira” prej 1.209.459 lekësh, në deklaratën e interesave periodikë/privatë viti 2005, nuk ka deklaruar pasuri apo shtim pasurie për “likuiditetet e lira” prej 1.682.934 lekësh, dhe as në deklaratën e interesave periodikë/privatë viti 2006 nuk ka deklaruar pasuri apo shtim pasurie për “likuiditetet e lira” prej 1.781.908 lekësh.

⁸⁰ Vendimet nr. 8/2019 (JR), nr. 11/2019 (JR), nr. 19/2019 (JR), nr. 29/2019 (JR), nr. 1/2020 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁸¹ Sipas analizës së subjektit të rivlerësimit, totali i shpenzimeve jetike – ushqim, veshmbathje, shtuar principal + interesa {***}, shtuar interesat e overdraftit duke mos konsideruar likuiditetet në cash, deklaruar prej 1.500.000 lekësh.

⁸² Data kur është kryer pagesa e paradhënies.

⁸³ Sipas lëvizjeve të llogarisë së pagës në {***}, bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 07.11.2018.

përballuar shpenzimet⁸⁴ deri në datën 29.04.2008 prej 1.240.764 lekësh⁸⁵, referuar analizës së paraqitur nga subjekti në aktin e ekspertimit për vitin 2008. Nëse në analizën e kryer në Kolegj, do të shtoheshin shpenzimet e udhëtimit, të kryera nga data 01.01.2008 deri në datën 29.04.2008⁸⁶, dhe ndryshimet e gjendjes së likuiditeteve në llogari bankare⁸⁷, mungesa e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera nga subjekti deri në pagesën e paradhënies për automjetin, do të thellohej duke rezultuar në vlerën e pajustificuar me burime të ligjshme për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve prej (-)135.650 lekësh. Gjithashtu, nëse në analizën financiare të Kolegjit për vitin 2007, do të përfshiheshin shpenzimet e udhëtimeve sipas raportit TIMS, për gjashtëmbëdhjetë udhëtime të kryera nga familja gjatë vitit 2007 dhe ndryshimin e likuiditeteve në llogaritë bankare, kursimet e mundshme të subjektit të rivlerësimit, znj. Dhuarata Haveri, në fund të vitit 2007 do të ishin më pak se 758.568 lekë, duke u thelluar më tej mungesa për të justifikuar me burime të ligjshme pagesën e kryer më datë 29.04.2008.

18.9. Duke i qëndruar analizës financiare të vitit 2007 të kryer në Komision, ku subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar pasuritë në vlerën prej (-) 906.686 lekësh, duke mundur të kursejnë në *cash* deri në shumën prej 593.314 lekësh⁸⁸ dhe duke i shtuar të ardhurat e krijuara deri në datën 29.04.2008 nga subjekti i rivlerësimit, në shumën prej 474.139 lekësh⁸⁹ nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë⁹⁰, në total të ardhura rezultojnë në shumën prej 1.067.453 lekësh. Këto të ardhura nuk justifikojnë shpenzimet e kryera nga 01.01.2008 - 29.01.2008 në vlerën prej 1.314.357 lekësh⁹¹. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit konfirmon mungesën e burimeve financiare të ligjshme për pagesën e paradhënies për automjetin, në vlerën prej (-) 246.904 lekësh.

⁸⁴ Pa përfshirë shpenzimet e udhëtimeve sipas raportit TIMS dhe ndryshimin e likuiditeteve në llogaritë bankare.

⁸⁵ Deri më 29.04.2008, subjekti do të kishte kryer shpenzime për një total minimalisht prej 1.240.764 lekësh, si total: a) i pagesave të kësteve të kredisë në {***} prej 419,63 eurosh ose prej 51.532 lekësh, konvertuar me kursin mesatar të vitit sipas Bankës së Shqipërisë (sipas lëvizjeve në {***} bashkëlidhur shkresës nr. {***}, datë 14.11.2018); plus b) shpenzime jetese përpjesëtimore për 4 muaj, 546.480 lekë/12 muaj x 4 muaj =182.160 lekë; plus c) interesat e overdraftit prej 6.941 lekësh (sipas lëvizjeve në {***}, bashkëlidhur shkresës nr. {***}, datë 7.11.2018); plus d) parapagimi i bërë në {***} prej 8.000 eurosh dhe 165 euro si komision administrimi (sipas lëvizjeve në {***}, bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 16.11.2018) ose ekuivalenti prej 1.000.131 lekësh me kursin e datës 29.04.08, sipas publikimeve të Bankës së Shqipërisë.

⁸⁶ Sipas raportit TIMS për tri udhëtime të subjektit dhe bashkëshortit me destinacion Malin e Zi, me autoveturë apo dhe me këmbë.

⁸⁷ Shtuar me 47.128 lekë, si diferencë e gjendjes së llogarive bankare në 29.04.08 prej 47.309 lekësh, me gjendjen e llogarive bankare në fund të vitit 2007 për subjektin dhe bashkëshortin e saj prej 181 lekësh, në {***}, {***}, {***}, {***}, {***}.

⁸⁸ Nga shuma e deklaruar prej 1.500.000 lekësh.

⁸⁹ Sipas lëvizjeve të llogarisë së pagës në {***}, bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 07.11.2018, dhe vërtetimit nr. {***} prot., datë 17.10.16, nga KLD-ja për periudhën 17.12.07 - 20.12.12.

⁹⁰ Konsideruar të marra deri në këtë datë, pasi nuk ka informacion për datën e marrjes së pagesës.

⁹¹ Si total: a) i shpenzimeve të jetesës për 4 muaj për familje me 4 persona, prej 182.160 lekësh; b) i pagesave për kredinë në {***} (principal dhe interesa) prej 419,63 eurosh ose prej 51.532 lekësh; c) i paradhënies dhe komisionit të administrimit, paguar më 29.04.2008, prej 8.165 eurosh ose 1.000.131 lekësh; d) i interesave overdraft prej 6.941 lekësh; e) i ndryshimeve të likuiditeteve në bankë prej +47.128 lekësh; ë) i gjendjes më 29.04.2008 prej 47.309 lekësh - gjendjen në fillim të vitit 2008 prej 181 lekësh; f) i shpenzimeve për udhëtimet e kryera deri më 29.04.2008, prej 26.464 lekësh - sipas raportit TIMS për tri udhëtime të subjektit dhe bashkëshortit, me destinacion Malin e Zi, me autoveturë apo dhe me këmbë.

19. Për sa i përket apartamentit me sip. ndërtimi $95 \text{ m}^2 + 14,3 \text{ m}^2$ në Farkë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë të mbështetura dhe, si pasojë, gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri, sipas arsyetimit që do të shtjellohet në vijim.

19.1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, për apartamentin në Farkë, sipas kontratës së porosisë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.05.2013, ka deklaruar si burim të ardhurat nga puna dhe kredia sipas kontratës me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.12.2012, nga {***}, në shumën prej 5.000.000 lekësh, si dhe detyrim të prapambetur shoqërisë “{***}”⁹². Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në po këtë deklaratë, ka deklaruar detyrim të palikuiduar ndaj shoqërisë “{***}” për shkak të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.05.2015, sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.05.2015, në vlerën prej 19.000 eurosh.

19.2. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se çmimi i shitjes prej 60.000 eurosh ishte paguar sipas kontratës së shitjes, datë 04.05.2015, sipas kushteve të kontratës së porosisë, datë 15.05.2013⁹³. Kontrata e porosisë parashikonte se me lidhjen e saj, do të paguhej kësti prej 15.000 eurosh, ndërsa për këstin e dytë prej 35.000 eurosh dhe këstin e tretë prej 10.000 eurosh, nuk kishte afate të përcaktuara. Shoqëria “{***}”, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka konfirmuar se sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.05.2015, për detyrimin prej 19.000 eurosh, si diferencë e kontratës së shitjes, deri në atë datë nuk ishte bërë asnjë pagesë.

19.2.1. Në analizën financiare të vitit 2013, Komisioni nuk ka konsideruar pagesë të kryer në funksion të kësaj pasurie, pavarësisht përcaktimit në kontratën e porosisë për pagesën e kështit të parë prej 15.000 eurosh.

19.2.2. Në analizën financiare të vitit 2014, Komisioni ka konsideruar pagesën me marrjen e kredisë në shumën prej 4.924.312 lekësh ose 36.000 eurosh, sikurse dhe subjekti i rivlerësimit në aktin e ekspertimit, datë 16.07.2019, ndërsa Komisioni shumën prej 3.362.640 lekësh ose 24.000 eurosh e ka përllogaritur si detyrim të cilin gjithashtu edhe subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar si detyrim në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë 2014. Komisionit i ka rezultuar se në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, kishte mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe për të kryer shpenzimet në vlerën prej (-) 1.670.039 lekësh.

19.2.3. Në analizën financiare të vitit 2015, Komisioni ka konsideruar se subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesën prej 688.250 lekësh ose prej 5.000 eurosh⁹⁴. Komisionit i ka rezultuar në analizën

⁹² Sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.05.2015, dhe deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.5.2015.

⁹³ Referuar kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.05.2013 dhe kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.05.2015.

⁹⁴ Duke qenë se ajo ka deklaruar në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë 2015, detyrimin prej 19.000 eurosh ndaj shoqërisë “{***}”, si dhe duke pasur në konsideratë deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë

totale të vitit 2015, se subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, kishte mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera në vlerën prej (-) 323.869 lekësh.

19.3. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, për pagesën e kryer në vitin 2014, rezulton i provuar burimi i ligjshëm nëpërmjet kredisë bankare, transferta nga llogaria bankare të shitësi. Ndërsa për pagesën e kryer në vitin 2015, trupi gjykues i Kolegjit konfirmon minimalisht të njëjtin rezultat në analizën e vitit 2015, si Komisioni në vlerën prej (-) 323.869 lekësh, vlerë për të cilën subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme për të mbuluar pagesën e çmimit të apartamentit dhe shpenzimet e tjera të kryera gjatë vitit. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Komision për vitet 2014 dhe 2015, Kolegji konfirmon minimalisht të njëjtin rezultat të analizës për këto vite, ashtu si dhe Komisioni, për vitin 2014 në vlerën prej (-) 1.670.039 lekësh, për vitin 2015 në vlerën prej (-) 323.869 lekësh.

20. Për sa i përket analizës financiare për vitet 2006, 2007, 2009, 2011, 2014 dhe 2015, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar me burime financiare të ligjshme shpenzimet e kryera, sipas arsytimit që do të shtjellohet në vijim.

20.1. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga *honorarët* e mbledhjeve të zhvilluara në cilësinë e anëtares së ish-KLD-së për periudhën 17.12.2007 - 20.12.2012⁹⁵, të cilat pretendon se Komisioni në mënyrë të padrejtë, të paqartë dhe të pajustificueshme nuk i ka njohur⁹⁶.

20.1.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk është i mbështetur në prova, për arsye se Komisioni i ka konsideruar të ardhurat e pretenduara nga subjekti të përfituara si anëtare e ish-KLD-së në vitet 2008 - 2013, në total në vlerën prej 639.000 lekësh, si dhe honorarëve të mbledhjeve të Komisionit të Posaçëm të Mbrojtjes së Gjyqtarëve për vitet 2011 - 2012⁹⁷, në total në vlerën prej 81.000 lekësh, sipas deklarimeve të subjektit në deklaratën e

21.05.2015. Pra, nga detyrimi i deklaruar në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë 2014 prej 24.000 eurosh, në detyrim të mbetur në vitin 2015 prej 19.000 eurosh dhe sipas deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit, rezulton e paguar vlera prej 5.000 eurosh, për të cilën nuk ka dokumentacion për moment ekzakt të pagesës së kryer, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë si pagesë në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë 2015.

⁹⁵ Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 17.10.2016 dhe vërtetimit nr. {***} prot., datë 24.10.2016 të KLD-së, me cilësinë e ish-anëtares së Komisionit të Posaçëm të Mbrojtjes së Gjyqtarëve për periudhën 01.01.2011 - 31.12.2016, në vlerën prej 639.000 lekësh dhe 81.000 lekësh, në total 720.000 lekë.

⁹⁶ Duke u bazuar në vërtetimin nr. {***} prot., datë 04.11.2019, të KLGj-së.

⁹⁷ Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, të konsideruara në analizë nga Komisioni, me ato të konsideruara në analizën e subjektit, për vitin 2011 Komisioni ka konsideruar më shumë të ardhura + 40.000 lekë dhe për vitin 2012 subjekti në analizë ka konsideruar më shumë të ardhura se Komisioni +40.000 lekë. Konstatohet se Komisioni i ka konsideruar të ardhurat e pretenduara nga subjekti në ankim, të përfituara si ish-anëtare e KLD-së, respektivisht në shumat 130.500 lekë në vitin 2011 dhe 148.500 lekë në vitin 2012, pra pretendimi i subjektit duket se nuk qëndron. Ndërsa, për sa u përket të ardhurave të pretenduara të honorarëve të mbledhjeve të KPMGj-së (2011-2012), konstatohet se Komisioni i ka konsideruar këto të ardhura dhe i ka shpërndarë në vitet 2011 dhe 2012, pra pretendimi i subjektit se Komisioni nuk i ka konsideruar në analizë, duket se nuk qëndron. Ndërsa subjekti në analizën e sjellë prej tij i ka

pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe vërtetimet nr. {***} prot., datë 17.10.2016 dhe nr. {***} prot., datë 24.10.2016, të KLD-së.

20.2. Kundërshtimi i subjektit të rivlerësimit për sa i përket *konsiderimit nga Komisioni të shpenzimeve për udhëtimet e kryera në Spanjë, Francë dhe Portugali në vitet 2005 - 2009*, duke pretenduar se janë kryer për shkak të pozicionit të saj si anëtare e ish-KLD-së dhe shpenzimet janë mbuluar nga KLD-ja apo mbështetur nga organizata si Euralius apo Këshilli i Evropës, nuk është i mbështetur në prova, sipas arsyetimit që do të shtjellohet në vijim.

20.2.1. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri⁹⁸, ka deklaruar në total shtatë udhëtime pune, prej të cilave dy udhëtime në Francë, përkatësisht në janar 2008 dhe qershor 2010, një udhëtim në Spanjë, në maj - qershor 2009, një udhëtim në Portugali në nëntor 2009, një në Holandë në janar 2015, dhe dy në Angli në janar 2011 dhe maj 2012⁹⁹.

20.2.2. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni nuk i ka konsideruar dhe nuk e ka ngarkuar subjektin e rivlerësimit në analizën financiare të kryer prej tij me shpenzimet e udhëtimit për në Pragë në vitin 2006, në Portugali në vitin 2009, në Francë në vitet 2008 e 2010 dhe në Angli në vitet 2010 e 2012¹⁰⁰, ndaj për këto udhëtime pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë të bazuara.

20.2.3. Për udhëtimin në Spanjë në maj - qershor 2009, Komisioni është shprehur në tërësi se: “Shpenzimet e udhëtimeve jashtë Shqipërisë janë përlllogaritur bazuar në sistemin TIMS, duke përdorur një metodologji të përcaktuar nga KPA në gjykime të mëparshme”, duke kryer një analizë financiare shteruese, shpenzimet e këtij udhëtimit do të ishin në vlerën prej 450 eurosh ose 59.426 lekësh¹⁰¹.

20.2.4. Në vijim të arsyetimit të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në analizën financiare për vitin 2009, shpenzimet e udhëtimit në total, Komisioni i ka konsideruar në vlerën prej 103.247 lekësh. Duke pasur parasysh që gjatë këtij viti, përveç udhëtimit të subjektit të rivlerësimit në Spanjë, familja ka kryer dhe udhëtime të tjera, përkatësisht në datat 13 - 17 shkurt 2009 në Turqi, subjekti dhe bashkëshorti me *charter*, në datat 21 - 28 gusht 2009, bashkëshorti dhe fëmijët në Greqi me makinë, dhe në datat 30 dhjetor 2009 - 4 janar 2010 e gjithë familja në Itali me avion,

konsideruar këto të ardhura prej 81.000 lekësh, si të ardhura vetëm në vitin 2012, Komisioni duket se i ka shpërndarë në vitet 2011-2012.

⁹⁸ Regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 23.08.2019.

⁹⁹ Gjithashtu, ka rezultuar dhe një udhëtim tjetër në Pragë në vitin 2006, shpenzimet e të cilit ishin mbuluar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda sipas shkresës nr. {***} prot., datë 06.08.2019.

¹⁰⁰ Për udhëtimin në Pragë në vitin 2006, Portugali në vitin 2009 dhe Francë në vitin 2010, sipas rezultateve të hetimit administrativ shtesë, datë 17.09.19, ku shprehet se “këto udhëtime janë hequr si shpenzime nga analiza financiare për subjektin”; për udhëtimet në Angli në vitet 2011 dhe 2012, referuar analizës financiare (faqes së fundit), pas rezultateve hetimore shtesë, datë 17.09.19, ku shprehet se: “Për udhëtimet në Angli nuk është përlllogaritur asnjë lloj shpenzimi, bazuar në deklaratën noteriale të lëshuar nga pritësi”; për udhëtimet në Francë në vitin 2008, referuar analizës financiare (faqes së fundit), pas rezultateve hetimore shtesë, datë 17.09.19, ku shprehet se: “Për udhëtimet për arsye pune, shpenzimet e të cilave janë paguar nga institucioni/et, nuk është përlllogaritur asnjë lloj shpenzimi”.

¹⁰¹ 50 euro qëndrimi x 4 ditë dhe 250 euro udhëtimi me Alitalia për në Spanjë, linjë jodirekte.

dhe duke kryer llogaritjen sipas metodologjisë orientuese të Kolegjit për udhëtimet¹⁰², shpenzimet për këto udhëtime do të rezultojnë në vlerën më të lartë se llogaritja e Komisionit prej 1.613 eurosh ose 212.950 lekësh¹⁰³, rrethanë të cilën trupi gjykues e vlerëson që të mos reflektohet në analizën e Kolegjit në kushtet e mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit në ankim.

20.3. Kundërshtimi i subjektit të rivlerësimit *për sa u përket deklaratave të pasakta të të ardhurave të bashkëshortit*, me argumentin se ishte në vështirësi dhe pamundësi për arsye se afati i deklaratës në ILDKPKI mbaron në datën 31 mars të vitit kalendarik, ndërkohë mbyllja e bilancit për efekt të tatimeve nga ekonomisti i personit fizik, noter, vjen më vonë në kohë, nuk është i mbështetur në prova.

20.4. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, ka deklaruar të ardhurat nga aktiviteti privat si avokat në vitet 2003 – 2009, në vlerën prej 1.600.000 lekësh dhe gjithashtu si noter, por pa përcaktuar vlerën. Në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë ka deklaruar të ardhura si avokat në vitet 2004 – 2007, në total në vlerën prej 4.020.000 lekësh¹⁰⁴ dhe, nga aktiviteti si noter në vitet 2012 – 2015, në total në vlerën prej 2.320.000 lekësh.

20.5. Duke i krahasuar të ardhurat e deklaruara me shkresat e DRTT-së¹⁰⁵, të ardhurat e krijuara nga aktiviteti si noter gjatë viteve 2012 - 2016, bashkëshorti rezultonte me xhiro prej 3.830.312 lekësh dhe fitim prej 1.293.128 lekësh, vlerë kjo më e ulët nga sa është deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë, në total në shumën prej 2.320.000 lekësh.

20.6. Për aktivitetin si avokat të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, nuk rezultuan të ardhura të dokumentuara, ndryshe nga deklaratat në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit prej 1.600.000 lekësh dhe ato në deklaratat e interesave periodikë/vjetorë për periudhën 2004 – 2007, në total prej 4.020.000 lekësh¹⁰⁶.

20.7. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, përveç vitit 2014, deklaratat e bashkëshortit në DRTT, janë kryer para deklaratës në ILDKPKI, përkatësisht formulari i deklaratës të tatimit të thjeshtuar mbi

¹⁰² Vendim nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹⁰³ Si total: a) për udhëtimin në Turqi, 4 net x 50 euro x 2 veta = 400 euro qëndrimi dhe 100 euro x 2 veta = 200 euro bileta për charter, në total 600 euro; b) për udhëtimin në Greqi, sipas pyetësorëve, destinacionet janë Athinë, te familja e bashkëshortit, e sipas deklaratës noteriale të z. A. H nr. {***} kol., dt 22.08.2019, konfirmon për qëndrimin te ta, llogaritur 5 euro x 7 netë x 3 veta = 105 euro dhe udhëtimi me makinë (pa informacion e kujt është pronësia e makinës), Tiranë – Kakavijë – Athinë 732 km x 2 vajtje-ardhje x 7 lt/100 km x 1,049 euro (kosto karburanti) + 40 euro kartoni jeshil = 148 euro, pra në total 253 euro; c) për udhëtimin në Itali, Romë, sipas pyetësorëve, destinacionet janë Romë, te mikja e subjektit, e sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.08.2019, nga B. E ku deklaron se ka mbuluar të gjitha shpenzimet e akomodimit, përfshirë fjetje, ushqim dhe lëvizjet në qytet të Dh. Haveri, sa herë ka ardhur në Itali, llogaritur 5 euro x 2 net x 4 veta = 40 euro, me avion me Alitalia 4 veta x 180 euro vajtje-ardhje = 720 euro, pra në total 760 euro.

¹⁰⁴ Në vitin 2007 i ka deklaruar së bashku të ardhurat nga aktiviteti si avokat dhe si regjisor.

¹⁰⁵ Nr. {***} prot., datë 20.07.2017, dhe me të ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 21.07.2017 (aneksi 34).

¹⁰⁶ Nëse nuk do konsideronim atë të deklaruar në vitin 2007, pasi deklarohen së bashku të ardhurat si avokat dhe si regjisor në shumën 1.600.000 lekë, do të ishin për vitet 2004-2006 në shumën 2.420.000 lekë.

fitimin e vitit 2013, është deklaruar në datën 10.02.2014¹⁰⁷, formulari i deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2014, është deklaruar në datën 10.06.2015, formulari i deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2015, është deklaruar në datën 06.02.2016, formulari i deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2016, është deklaruar në datën 26.01.2017, ndërsa pasqyrat financiare për vitin 2012, të dërguara në DRTT në datën 22.03.2013, janë mbyllur në datën 20.03.2013¹⁰⁸. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ishte në vështirësi dhe pamundësi për arsye se afati i deklarimit në ILDKPKI mbaron në datën 31 mars të vitit kalendarik, ndërkohë mbyllja e bilancit për efekt të tatimeve nga ekonomisti i personit fizik, noter, vjen më vonë në kohë, nuk është i mbështetur në prova.

20.8. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, ka deklaruar shpenzime arsimimi për fëmijët, në vlerën prej 400.000 lekësh, për të cilat pretendon se provat e dorëzuara e mbulojnë plotësisht kërkesën e Komisionit për sqarim lidhur me shpenzimet e shkollimit dhe të jetesës jashtë vendit për të dy fëmijët.

20.8.1. Trupit gjykues të Kolegjit i rezulton se, pas prapësimeve të rezultateve të hetimit dhe në seancën dëgjimore, Komisioni i ka përfshirë në analizën financiare *shpenzimet e shkollimit sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit*¹⁰⁹, ndaj ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

20.8.2. Komisionit, gjatë hetimit administrativ për muajt gusht 2012 - qershor 2014, i rezultuan pagesat në total prej 1.367.978 lekësh ose prej 9.758 eurosh¹¹⁰, të kryera në favor të UNYT-së¹¹¹, për shkollimin e vajzës, znj. E. H, të cilat subjekti i rivlerësimit pretendon se i ka deklaruar në tërësi të shpenzimet e jetesës.

20.9. Në deklaratat e interesave periodikë/vjetorë, subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, ka deklaruar në vitin 2013 *shpenzime jetese prej 900.000 lekësh*, në vitin 2014 *shpenzime jetese (të ndryshme), prej 900.000 lekësh*, në vitin 2015 *shpenzime arsimimi prej 400.000 lekësh*.

20.10. Komisioni, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 07.08.2019, të UNYT-së, ka konsideruar në analizën financiare të vitit 2014, shpenzime jetese prej 900.000 lekësh dhe shpenzime shkollimi prej 583.208 lekësh, në total prej 1.483.208 lekësh, duke rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në vlerën prej (-) 1.670.039 lekësh. Nëse do të konsiderohej pretendimi se shpenzimet e jetesës, të deklaruara prej 900.000 lekësh, përfshijnë edhe shpenzimet e shkollimit të vajzës prej 583.208 lekësh, atëherë diferenca e mbetur e tyre, prej 316.792 lekësh, do të përbënte shpenzimet e jetesës së familjes. Duke i krahasuar këto shpenzime të mbetura të jetesës, të deklaruara në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë, prej 316.792

¹⁰⁷ Subjekti A. H me NIPPT {***}.

¹⁰⁸ Referuar akteve bashkëlidhur përgjigjes së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nr. {***}prot., datë 27.11.2018.

¹⁰⁹ F. 31, paragrafi i dytë i vendimit nr. 197, datë 27.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

¹¹⁰ Gjatë vitit 2012, paguar 309.019 lekë ose 2.220 euro, gjatë vitit 2013 ka paguar 475.295 lekë ose 3.375 euro, gjatë vitit 2014 ka paguar 583.665 lekë ose 4.163 euro.

¹¹¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 07.08.2019, e UNYT-së.

lekësh, me shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI-së për vitin 2014, për familje me 3 persona, prej 659.994 lekësh, ato do të ishin në vlerën 343.202 lekë më pak dhe, për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit përjashtoi mundësinë që, për këtë vit, së bashku me shpenzimet e jetesës së familjes, të jenë përfshirë edhe shpenzimet e shkollës së vajzës në UNYT, duke e konsideruar të pabazuar këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit.

21. Trupi gjykues i Kolegjit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, bazuar në aktet e administruara në dosjen e përcjellë nga Komisioni, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëshminë dhe aktet e depozituara nga dëshmitari, z. V. V, në seancën gjyqësore të datës 18.02.2022, si dhe gjetjen e vëzhgueses ndërkombëtare, çmoi se:

a) lidhur me apartamentin me sip. 135,9 m² në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, përfshirë edhe të ardhurat e deklaruara nga shitja e apartamentit me sip. 75,26 m² në Shkodër;

b) subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shlyerjen në datën 17.01.2005, të kredisë së marrë nga {***}, lidhur me apartamentin me sip. 135,9 m² në rr. “{***}”, Tiranë, në vlerën prej (-) 586.905 lekësh;

c) lidhur me garazhin me sip. prej 14 m² në Farkë, Tiranë, ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie;

ç) nga analiza financiare për vitet 2006, 2007, 2009, 2011, 2014 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, prej (-) 5.265.176 lekësh¹¹², për të justifikuar pasuritë apartament me sip. 111,5 m² në Shkodër, automjet tip “{***}”, dhe apartament me sip. ndërtimi 95 m² + 14,3 m² në Farkë, si dhe shpenzimet e kryera sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

22. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri, gjendet në kushtet e parashikuara nga pikat 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si edhe nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 197, datë 27.09.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra, është i mbështetur në fakte, prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

¹¹² Përkatësisht, për vitin 2006 në vlerën prej (-) 138.182 lekësh, për vitin 2007 në vlerën prej (-) 906.686 lekësh, për vitin 2009 në vlerën prej (-) 1.741.499 lekësh, për vitin 2011 në vlerën prej (-) 484.901 lekë, për vitin 2014 në vlerën prej (-) 1.670.039 lekësh, për vitin 2015 në vlerën prej (-) 323.869 lekësh, në total në vlerën prej 5.265.176 lekësh.

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 197, datë 27.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Haveri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall sot, në Tiranë, më datë 15.03.2022.

ANËTARE

ANËTARE

ANËTARE

Mimoza TASI

Natasha MULAJ

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

nënshkrimi

nënshkrimi

RELATORE

KRYESUES

Albana SHTYLLA

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

nënshkrimi